

BIBLIOTEKA

BSH-94


Q 40

HALIL QENDRO
IBRAHIM GANI



KRYENGRITJA E

Delvinës



Tiranë 2015

HALIL QENDRO
IBRAHIM GANI

KRYENGRITJA E DELVINËS

Botim i Dytë i plotësuar

*Qendro
PUBLIKO TËKËJ
SHKËRTË*

Qendro



608/15

Tiranë, 2015

Titulli i librit: Kryengritja e Delvinës
Autorë: Halil Qendro & Ibrahim Gani

Kopertina: Sokol Përmeti

Përkujdesia grafike: Dashamir Vraniçi

Sponsorizues:
Anatol Halil Qendro dhe vëllezërit e tij
Genci & Marenglen

Botimi i Parë: Revista periodike “Përpjekia”, Prill 1996, Nr. 6, Tiranë.

Botimi i Dytë është i përmirësuar me: Listat e të shpërblyerve dhe të dënuarve nga regjimi i Zogut, pjesëmarrës në kryengritje e shuarjen e saj; komentet e bëra nga shtypi vendas i kohës; shtypi botëror rreth Kryengritjes së Delvinës si dhe trajtesat e bërë nga historiografia komuniste e më pas prologu, Vajet, dhe këngët popullore për atë kryengritje.

Libri u shtyp në Shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese
“Marin Barleti”, Tiranë 2015

*“Tash, në minutën e vdekjes thërras:
Poshtë tirania! Rrofsh nacionalizmin!
Unë jam krijues i këtij revolucioni, as
kurrëkush tjetër dhe as gisht i huaj.”*

Et'hem Toto
Mali i Golëmit, 25 Maj 1937¹⁾

*“Bota nuk është e atyre që ngrohen,
bota është e atyre që digjen.”*

Ismet Toto

¹⁾ AQSH, Fondi Et'hem Toto, Dosja nr. 56, f.1

“Rrëzimi i qeverisë së Mehdi Frashdrit pati një rrjedhim tragjik. Një ditë të qershorit 1937 një shpallje zurtare njoftoi popullin shqiptar se Et’hem Toto, ish-ministër i mbrendëshëm në kabinetin Frashëri, kishte filluar një kroengritje me armë dhe ishte vra në luftë me forcat qeveritare... Misteri i këtij epizodi të përgjakun pret të ndriçohet nga historikruesit e ardhmë, që do të mund të konsultojnë arkivat e Tiranës pa mbikëqyrjen e Komisarëve të partisë”:

Tajar Zavalani "Historia e Shqipnis", Faqe 291

PROLOG

Në fshatin Progonat të krahinës së Kurveleshit, gjer në vitin 1950, pranë një arre të madhe, në lagjen Ndreaj, syri të zinte copra muresh ende të paprishura dhe togje me gurë. Në anën veriore të atyre rrënojave ishin dy qoshe muresh me gurë mermeri, të cilat arrinin gati një metër mbi brezin e katit të dytë të cilat ishin dëshmia më autentike e një ndërtese shumëkatëshe.

Gjatë pranverës, mbi ato copra muresh, vende-vende jeshilonin fije bari, ndërsa disa hapa para cepit të djathtë të gjurmëve të asaj ndërtese shpaloste gonxhet një trëndafil erëmirë. Të gjithë progonatasit e dinë se në ato troje dikur jetonte fisi i Totajve. Disa qindra metra në veri të atyre gërmadhëve, sikundër do të shkruante më vonë Selaudin Toto, vëllai i Et'hem Totos, ishte kroi, ku sa herë njomnin buzët dhe po aq herë lexonim në balloren e tij: "Kujtim prej dëshmorit Et'hem Toto". Disa ditë, fill pas pushkatimit të Selaudinit, në vitin 1946, u fshi edhe mbishkrimi në ballinën e kroit.

Nëse ndonjë ditë do të mund të ngrihet një muze ku të pasqyrohet jo vetëm historia e Progonatit, por edhe e krahinës së Kurveleshit, do të ishte më se e drejtë që ai të ngrihej mbi themelet e sarajeve të Totajve, pasi në atë vatër lirie lindën dhe u rritën breza të tërë patriotësh të shquar, të cilët kanë kontribuar madhërisht për lirinë dhe mëvetësinë e mbarë trojeve amëtare.

Në fletët e librit "Mbi historinë e Progonantit", me autor ish partizanin e ditëve të para të Luftës Antifashiste

Nacionalçlirimtare e më pas kuadër i nderuar i Ushtrisë Popullore Shqiptare dhe i administratës shtetërore, Muharrem Xhufi, përmes sa e sa shembujve, ai shpalo luftime, por edhe beteja të përgjakshme të popullit të Kurveleshit, si me pushtuesit shekullorë otomanë ashtu edhe me shovinistët grekë. Në ato luftime e beteja, bijtë e fisit Toto, Belul e Alem Toto, zenë një vend të nderuar jo vetëm si organizatorë e udhëheqës të atyre luftimeve, por edhe si largpamës të së nesërme së popullit dhe atdheut të vet.

Në librin e sipërcituar tregohet sesi në ato vite ashtu edhe më vonë, Kurveleshi dhe mbarë krahina e Labërisë ishte shndërruar në një vullkan kundër pushtuesve. Përkrah prijsave të tjerë kurvelehas si Çelo Picari, Çobo Golëmi, Bilbil Shako prinin edhe kapedanët progonatas Belul Toto, Asllan Kuca, Alem Toto e shumë e shumë të tjerë. Stambolli për t'i gjunjësuar këta trima dhe shumë të tjerë, përveç përdorimit të shpatës e plumbit, përdori dëndur edhe tradhëtinë, litarin, thikën, zjarrin, helmin, internimin si dhe shpërnguljet masive. Gjatë pushtimit turk 500 atdhetarë të shquar të trevave Jugore të Shqipërisë u ekzekutuan në "Gostinë" e njohur me emërin Masakra e Manastirit. Belul Toto, edhe pse e parandjeu se diçka do të ndodhte në atë "pritje të madhe" dhe nuk ra pre e asaj gracke, në betejat e mëvonshme do të binte në ballë të sulmit për mbrojtjen e trojeve shqiptare. Ligjet e trevës labe, që koha me një befasi të mahnitëshme i shndërron në këngë, e gdhendi Belul Toton ashtu si e njohu koha kur "djemtë e Kurveleshit / luftonin me pallë sheshit", e njohu edhe historia:

Trihallë e zeza Trihallë,
Nuk ka se kush të të marrë,
Mbet Beluli në Trihallë...

Pas Belul Totos, biri i tij, Alem Toto ndoqi udhën e babait me një përkushtim adhurues. Përveç që ishin ballëtarë në fushën e betejës, ai dhe pasardhësit e tij ishin edhe kërkues këmbëngulës që në trevat shqiptare të flitej gjuha amtare. Qëndrimi dhe veprimet e tij shqetësuan sunduesin por edhe kishën greke. Edhe kundër Alem Totos u përdor si armë asgjësuese helmi në filxhanin e kafesë. Progonati e qau me ligje, që drithëronin edhe gurët:

Ç' të të them, o Progonat nuri,
Mes për mes të shkoi lumi
Që kur vdiq Alem Beluli...



Et'hem Toto



Ismet Toto

NË DOSJET ZOGISTE

Pas Kryengritjes së Fierit dihet që gjëndja ekonomike dhe politike në vend u rëndua edhe më shumë. Korrupsioni, varfëria dhe gjakmarrja u ngjitën në shkallën më të lartë. Në Dosjen nr.101, Fondi i Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme, AQSH, fleta 12, midis të tjerave pohohet:

“Gjendja në Prefekturën e Dibrës është fort e keqe, ku zotërinjtë Majorë në rezerve, formojnë klikat dhe grupet e veta. Në njerën anë janë: Major rez. Sul Shehu, Murat Kaloshi dhe Cen Elezi. Në anën tjetër major Dine Kandri, ish kapiten Gani Mustafa dhe kapiteni në rezervë Mehdi Kasa”. Në raport jepet qartë se “të dy palët kanë filluar vrasjet midis tyre. Më i keqi ndër ta është Majori në rezervë Sul Shehu si kryetar Bashkie, pa kurfarë kontrolli po bën ditë për ditë të zeza në popull.”

Në ato përjetime dramatike, Et’hemi, i cili ishte zevendës Prevekt i Dibrës, më mirë se cilido dëgjoi se si rrihte zemra e popullit të shumëvuajtur, ndaj dhe sipas urdhërit të Zogut i eliminoi klikat. Rritja e respektit dhe e mirënjohjes që shfaqën banorët e trevave veriore për Et’hem Toton dhe mbështetja e fuqishme që i jepte Et’hemi “elitës së djalërisë shqiptare”, e thelloi më shumë hendekun midis Et’hem Totos dhe Ahmet Zogut. Në atë situatë tepër të rënduar, Ahmet Zogu kërkoi sërish të dhëna të reja për çdo ushtarak e nëpunës shteti, që kishin

mbështetur e simpatizuar Kryengritjen e Fierit.

Në Dosjen nr.22, Fondi Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme, viti 1935, f.205, shkruhet: "Et'hem Toto, prefekt i Shkodrës, kishte lajmue Komitetin Qendror se aj e merrte Shkodrën në rast kryengritje, por duhesh qërue që më parë komandanti i Grupit Ismail Osmani. Ky ishte besnik i Zogut, trim, e dojshin shumë ushtarët."

Në Dosjen nr.23, Fondi Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme, viti 1935, midis të tjerave shkruhet: "Shkodër. Et'hem Toto në ditët e kryengritjes do ta niste marrshimin tue pengue misionin e fuqive ushtarake. Dhe nëqoftëse Tirana do të insistonte të nisësh, atëherë fuqia e Shkodrës do të bashkohej me kundërshtarët".

Në Dosjen nr. 50, Fondi Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme, viti 1935, shkruhet: " Nga deponimet e një kryetari çete nga Cakrani, Sulo Jashar Cakrani, ka pohuar: Fuqitë, kështu të bashkuara do të shkonin në Priskë ku do të bashkoheshin me fuqinë e Shkodrës, të cilat po atë natë (14-15 e muajit kryengritës) do të kishin zënë Krujën e, si të bashkoheshin me ato të Krujës,... po atë natë nga qafa e Krabës do të sulmonin Tiranën dhe Elbasanin. Bashkluftëtarët e Et'hem Totos, që akuzohen për lidhje me Lëvizjen e Fierit janë: Xhevdet Gjoleka, Rakip Duka, Muharrem Duka, të tre nga Kurveleshi dhe Haki Rushiti."

Në Dosjen Nr. 51, Fondi Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme, viti 1935, shkruhet: "Telegram shifër 27.8. 1935, Drejtuar Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme dhe Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Në proceset e mbajtura nga hetuesi i gjyqit politik në komandën e Operacionit, Ahmet Sheh Karbunara, tash deklaroi sa vijon: Nga oficerët pjestarë që kanë qenë hyrë: N/Kolonel

Fiqiri Dinia, Major Faik Quku, komandanti i Grupit të Dytë të Elbasanit Kapiten Et'hem Toto, kapiten Neki Daci. (Këtë pohim e bën Ahmet Shehu)“.

Në Dosjen nr.36 të po atij fondi, në letrën e dërguar Sydbi Topullit, Komndant i Gjindarmërisë së Tiranës, nga i quajturi Anastas Vangjeli, midis të tjerave thuhet: “Shkova në Kuç. Erdh në shtëpinë time Xhevdet Gjonleka... Ra fjala për kryengritjen e Fierit. Më deklaroi se në këtë kryengritje ka pasur pjesë 80% ushtria dhe midis tyre një pjesë e mirë e bajraktarëve të Veriut. Plan kryengritja në Fier, më deklaroi, u bë pa u pjekur koha”.

Kurthi i dështuar i Ahmet Zogut

Koha dëshmoi se qeveria e kryesuar nga Mehdi Frashëri ishte një grusht jo vetëm për qeveritarët me poste më të larta, por edhe për vetë Ahmet Zogun. 21 Tetori 1935 ishte një fitore e madhe e Elitës së Djalërisë Intelektuale. “Ky triumf historik – theksonte Ismet Toto – i frymëzuar prej shpirtit të pastër të intelektualëve të vërtetë dhe i përgatitur nga fuqitë morale dhe materiale të popullit, gjeti përkrahjen e merituar të pushtetit dhe në këtë mënyrë, në historinë e evolucionit ideologjik dhe politik të popullit tonë caktoi pikënisjen e zhvillimit normal të parimeve moderne në organizmën shtetërore dhe pikëmbarrimin e sundimit të mentalitetit oriental, i cili ka pasur në dorë gjithë fatin e Atdheut, duke qeverisur sipas parimit të kohrave të Tanzimatit.”²

Është i mirënjohur fakti se Ahmet Zogu kur e gjykonte se prefektët e kishin mbushur përplot kupën e

² I. Toto: “Agonia e ideologjisë së vjetër Arbërore”, Tiranë, 1936. f. 66

korrupsionit, dekretonte shkëmbimet e tyre, duke u ndërruar qytetet. Dekretet shpalleshin me urdhër të Mbretit.

Në emërimet e vitit 1936, Ahmet Zogu ndoqi një rrugë tjetër. Me urdhër të tij, në gazetën "Besa" të Abdurahman Dibrës, u botua lista e emërimit të prefektëve, një ditë para se të delte dekreti i mbretit. Ahmet Zogu thirri urgjentisht Et'hem Toton dhe kërkoi prej tij të zbardhte se kush e kish dhënë urdhërin për botimin e listës për emërimin e prefektëve para se të delte dekreti i Mbretit. Ahmet Zogu po atë ditë e mori shumë shpejt përgjigjen nga Et'hemi: Urdhërin e kish dhënë vet ai, Mbreti. Atëherë Abdurahman Dibra u ankua me shkrim te Ahmet Zogu, si më poshtë:

Tiranë më 30/8/1936

Nalt Madhërisë së tij Zog I

Mbret i Shqiptarëve

Nalt Madhëri,

Me përulësi marr guximin me u parashtrua N.M. S'uaaj se: Më 27 të muajit Gusht, vazhdues, ditën e enjte, ora 16, simbas ftesës që më bani Ministri i P. Mbrendshme z.Et'hem Toto, shkova në zyrën e tij, i cili në atë minutë ndodhesh në kambë. Dhe me të hyrë unë mbylli portën me çelës dhe m'u drejtue tue më thanë me za të naltë se: "Çështja e qarkores që u botue në gazetën "Besa" i ka kushtue jetën, e prandaj nxjerreni koburen të vritmëni, ose do të më kallxoni se ku e keni marrë" dhe ai e nxorri koburen kundrejt meje tue më kërcënue me vrasje e tue më diktue nji deklaratë, të cilën e nënshkrova me kërcënim.

Mbas këtij incidenti Ministri dërgoi në shtypshkronjë fuqi policore dhe e konfiskoi arbitrarisht gazetën "Besa" ende të pabotueme dhe porositi që, përveç "Vatrës" e "Arbënisë", të mos

botohet asnjë gazetë, broshurë, dmth na ndalonte na (neve) të botojmë edhe ndonjë afish tjetër..... Kërkoj të urdhnoni ndjekjen ligjore kundra guximitarit të veprave të parashtruem këtu naltë.”³

Ahmet Zogu, nga vila e tij në Durrës, më 26 Shtator 1936, me shkresën nr. 477, kërkonte prej Kryeministrit Mehdi Frashëri të dhëna më të plota për ngjarjen si dhe për masat që duhesh të merreshin ndaj Et’hem Totos. Kryeministri, në përgjigje të “Urdhënit Mbretëror” nr.477 shkruan:

“... Zakoni i duelit është zakon i hershëm... Kjo çështje nuk formon objekt me marrë në gjyq një ministër në Gjykatoren e Naltë... se xheste të tilla ma mirë të mbeten të mbylluna se sa të përhapen me provokimin e një gjyqi papërfundim”

Me nderime

Kryeministri

Mehdi Frashëri”

³ Dosja nr.451, Fondi Kryeministrisë, viti 1936, fleta 4

DY ATENTATE

Ahmet Zogu, pas rrëzimit të Qeverisë së kryesuar nga Mehdi Frashëri, i vuri detyrë vetes të vriste Et'hem Toton. Për këtë qëllim ai organizoi dy herë rresht atentat në Krugën e Durrësit, të organizuar nga Gjeneral Serreqi dhe Major Avdullai, por falë zgjuarsisë dhe shkathtësisë së Et'hemit, të dy atentatet dështuan me turp. Të dy atentatorët ngelën me gisht në gojë..

Mirëpo Zogu nuk hoqi dorë për vrasjen e Et'hemit, duke e ndjekur këmba këmbës, edhe në Delvinë. Vëllai i Abdurahim Dibrës dhe dibrani tjetër u paraqitën në Delvinë si tregëtarë lëkurësh. E zonja e shtëpisë që ata kërkuan ta merrnin me qera, nga e cila shtëpia e Et'hem Totos shihej si në pëllëmbë të dorës, nuk pranoi t'ua jepte ngaqë trembej prej xhandarëve. Vrasësit e kishin studjuar mirë terrenin, pasi nëse ata e merrnin atë shtëpi, prej saj mundej ta realizonin vrasjen e Et'hemit me të shtënën e parë.

Ky fakt dhe të dhënat e tjera që N/Prefekti merrte nga xhandarmëria për disa lëvizje të dyshimta, e detyruan N/Prefektin e Sarandës, Ismet Toton, vëllanë e Et'hemit, të jepte urdhër që dy "tregëtarët" të largoheshin menjëherë prej Delvine. "Tregëtarët" dibranë me të mbritur në Tiranë shkuan dhe u ankuan tek Ministri i Brendshëm, Musa Juka. Ky i fundit, me shkresë "Res. datë 11.1.1937", dërguar nënprefekturës së Sarandës,

midis të tjerave shkruan: "Qerim Pjeça nuk ashtë kurgja tjetër veç një matrapaz qi merret me tregëti të vogël. Ministri u tërheq vrejthe se për çdo ndalim duhet të merret miratimi i organit më të lartë."

Nënprefekti i Sarandës, Ismet Toto, menjëherë të nesërmen, në datë 12.1.1937, me shkresën nr. 4/4, i kthen ministrit Juka këtë përgjigje: "... Sot kemi nisur të shoqëruar për aty, bashkë me aktet përkatëse, Qerim Pecjan nga Dibra e Madhe. Asht tip krimineli. Ju gjet edhe një kamë. Nga hetimet dhe informatat indirekte rezulton se i përmenduri asht kriminel dhe se për qëllime të tilla do të ketë ardhur këndej".

KRYENGRITJA E DELVINËS

1. Organizimi dhe taktika që u ndoq.

Në pasditën e vonë të së shtunës së 15 Majit të vitit 1937, rreth orës 19.30, u dëgjuan krisma armësh nga oborri i shtëpisë së Et'hem Totos, në Delvinë. Ata që prisnin t'i dëgjonin ato krisma nga çasti në çast, e dinin që ato ishin sinjali i kryengritjes dhe u nisën menjëherë të bashkoheshin me atë grup njerëzish, në krye të të cilit printe ish Ministri i Punëve të Brendëshme, Et'hem Toto, kapiteni i parë Ismail Gjylbegu, kapiteni në lirim Xhevdet Gjoleka, togeri Tajar Goxho, togeri Xhelal Shtëpani, Idajet Hajno, Bejkush Gjoleka, Mato Qendro etj. Turma e njerëzve sa vinte e shtohet. Ndalesa e parë u bë në post-telegrafën e nënprefekturës, ku menjëherë u ndërpre çdo lidhje telefonike dhe ajo u vu nën kontroll të kryengritësve. Që andej iu drejtuan Bashkisë së qytetit Delvinë, nga ballkoni i së cilës Xhevdet Gjoleka shpalli para turmës së njerëzve kryengritjen e udhëhequr nga Et'hem Toto. Prej këndej kryengritësit shkuan në nënprefekturë, ku Et'hem Toto u foli xhandarëve të reshtuar për revolucionin që po niste dhe ata i prematuan t'i qëndronin besnikë. Ndërkaq ishin hapur depot e armatimit, të pajimeve si dhe burgu. Armët ua ndanë civilëve dhe së bashku me forcat e xhandarmërisë u bënë 70-80 veta.


Për më pak se gjysëm orë Delvina ishte në duart e

kryengritësve. Ky pushtim i menjëhershëm dhe pa asnjë rezistencë i nënprefekturës së Delvinës ishte rrjedhojë e një plani të hartuar me hollësi e të zbatuar me përpikmëri. Që paradite ishte ndërprerë edhe linja telefonike Sarandë-Vlorë, si dhe ishin lajmëruar njerëzit që do të vinin nga larg.

Në shtëpinë e tij, Et'hem kishte mbledhur bashkëpuntorët e tij më besnikë, ata që do të quheshin më vonë "Shtabi i kryengritjes", ku pat mbajtur një fjalim, duke vënë në dukje gjëndjen e mjeruar të popullit, tiraninë e qeverisë, paaftësinë e saj për të çuar përpara punët e vendit si dhe për përqëndrimin e pushtetit në duart e një grupi njerëzish të korruptuar e antikombëtarë. Vendi duhej çliruar prej tyre, por kjo nuk do të ishte aq e lehtë, ndaj e përfundoi atë fjalim me fjalët: "Duhet ta dini se shkojmë për të vdekur, prandaj secili duhet të ruaj një fishek për vete."

Gjithë mjetet motorike të nënprefekturës ishin vënë në dispozicion të kryengritjes. Rreth orës 20.30 autokolona e kryengritësve u nis në drejtim të Gjirokastrës. Ndalesa e parë u bë në Qafë të Muzinës, ku u çarmatos posta e xhandarmërisë.

Krejt ndryshe qëndronte puna në Jorgucat. Atje, bashkë me postën e xhandarmërisë ishte edhe Roja Kufitare në përbërje të së cilës ishte një numur i konsiderueshëm forcash, të kompletuara edhe me armatim të rëndë. Si rrjedhojë, ajo që do të përcaktonte suksesin e aksionit ishte befasia e goditjes. Për të realizuar befasinë u organizua sulmi me grupe. Një grup, i përbërë nga Xheladin Shtëpani, Ruzhdi Golemi dhe Bejkush Gjolekën u caktua të çarmatoste postën e xhandarmërisë; kurse grupi tjetër, i kryesuar nga Ismail



Gjylbegu mori detyrë të izolonte ushtarët e Rojes së Kufirit, që të mos mund të delnin nga fjetoret. Ndërsa grupi i tretë, i kryesuar nga Tajar Goxhua, do të mbante në rrethim shtëpinë e komandantit të Rojes Kufitare. Grupet u hodhën në veprim në mënyrë të menjëhershme, njëkohësisht me ndërprerjen e linjës telefonike dhe i realizuan detyrat sipas planit të caktuar. Si rrjedhojë u hapën depot, u muar armatimi dhe pajisjet, ndërsa linjën telefonike që lidhej me Greqinë nuk e ndërprejnë. Ky ishte aksioni më i rëndësishëm i kryengritësve gjatë marshimit në intenerarin Delvinë-Gjirokastër.

Në natën me yje të muajit maj autokolona udhëtonte e pashqetësuar përgjatë luginës së Dropullit të Poshtëm drejt Gjirokastrës. Kur arritën në hyrje të qytetit të përgjumur, në vendin e quajtur Shën-Thanas, një njësit kryengritës preu linjat e post-telegrafës. Në orën dy pas mesnate të gjitha forcat kryengritëse të ardhur nga Delvina u grumbulluan dhe qëndruan në sheshin "Çerçiz Topulli". Statuja e bronxtë e kryekomitetit ishte dëshmitarja e parë e asaj që po ndodhte. Këtu, në Gjirokastër do të kryhej aksioni më i rëndësishëm: vënia në zotërim e Prefekturës dhe e Qark-Komandës. Qyteti nuk kish marrë asnjë sinjal se një forcë e armatosur po vinte drejt tij. Rojeve që ishin zgjuar as u shkoi ndër mend se ajo zhurmë makinash që dëgjonin përbënte ndonjë rrezik për ata dhe për vetë qytetin që mbronin. Natyrisht, mënyra se si do të paralizohet xhandarëria e qytetit dhe se si do të vihej nën kontroll Prefektura, ishte menduar me kohë. Në krye të aksionit printe kapiteni i parë Ismail Gjylbegu me një grup xhandarësh e civilësh besnikë. Rojet porsa e shihnin e nderonin si eprorin e tyre, pasi e njihnin, ndërsa ai i çarmatoste pa u dhënë asnjë shpjegim.

Pasi i çarmatosi rojet, ai hyri në ndërtesën e Prefekturës, nxorri nga kazerma ushtarët dhe i vuri nën arrest. Pastaj u vu në lëvizje pjesa tjetër e kryengritësve, të cilët e vunë nën kontroll ndërtesën qeveritare.

Et'hemu me bashkëpuntorët e tij kryesorë u vendosën menjëherë në zyrat e Prefekturës dhe të Qark-Komandës. Në fjalimin e shkurtër që ai u mbajti xhandarëve të çarmatosur, Et'hemu u tha se po bënte një revolucion për të rrëzuar kabinetin qeveritar, i cili kishte një program të keq dhe se gjithë Shqipëria kish për ta pranuar programin e tij dhe se ata nuk duhej të dëshpëroheshin që ishin çarmatosur, se do të mbeteshin sërish ushtarakë, veç duhej që t'i qëndronin besnikë.

Ndërkohë, Tajari Goxho kishte shkuar për të rrethuar në shtëpi kreun e administratës së Prefekturës, Dedë Jakovën. Më vonë Tajari do të vijë të lajmërojë se prefekti Dedë kish mundur të delte tinëzishtë nga rrethimi. Et'hemin ky lajm nuk e shqetësoi fare, ndërsa, në të vërtetë, kjo arratisje e Prefektit do të ishte me pasoja për kryengritjen.

Kish mbetur për t'u kryer edhe aksioni i fundit: hapja e burgut. Kjo detyrë iu ngarkua Ismail Gjylbegut, i cili u nis për në kala ende pa zbardhur mëngjezi. Duke qenë se komandanti si dhe zëvendësi i tij i postës së xhandarmërisë së burgut ishin simpatizantë të kryengritësve, këta të fundit nuk e patën të vështirë të hapnin portat e kalasë së lashtë, në brendësinë e së cilës ishte ndërtuar burgu. Në planin e kryengritjes ishte parashikuar që të mos liroheshin të gjithë të burgosurit, por vetëm 50 prej tyre, të dënuarit më të rëndësishëm politikë, lista e të cilëve ishte hartuar para fillimit të aksionit kryengritës. Pikërisht, në momentin kur

Gjylbegu shqyrtonte listat, Dedë Jakova, i cili kish mundur të mblidhte një fuqi të vogël të armatosur, rrethoi kalanë. Burgu brenda ishte në zotërim të forcave kryengritëse, por po veprime me ngathtësi dhe rojet e jashtme të kalasë nuk ishin ndëruar ende. Filloi përpjekia. Gjylbegu kishte me vete vetëm 5-6 veta. Në këto rrethana u dha urdhër që të hapeshin të gjitha dyert e qelive të burgut dhe të delnin të gjithë të burgosurit. Në ndihmë të kryengritësve erdhi më vonë me forca të tjera edhe Tajar Goxho. Pas një ore e gjysëm luftimi forcat qeveritare u detyruan ta linin qytetin e Gjirokastrës. Nga të 240 të burgosurit, 70 prej tyre u bashkuan me kryengritësit.

Lufta në kala, ndonse nuk krijoi ndonjë rrezik për kryengritësit, pati pasoja të dëmshme. Sipas planit të kryengritjes, forcat e saj duhej të arrinin në Vlorë, brenda orës 15.00 të asaj dite. Mirëpo kjo orë i zuri kryengritësit duke luftuar ende në kalanë e Gjirokastrës, gjë që ata u desh ta kalonin edhe natën e dytë të kryengritjes në Gjirokastrë. Vetëm në ora 08.00 të datës 17 Maj, dita e tretë e kryengritjes, autokolona filloi lëvizjen për në drejtim të Tepelenës.

Në Gjirokastrë u lanë 60 kryengritës nën komandën e Rami Kamberit. Po kështu ishte vepruar edhe në Delvinë dhe më pas edhe në Tepelenë, duke lënë një sasi forcash për të mbajtur rregullin dhe qetësinë. Këto forca përfaqësonin pushtetin e kryengritjes dhe kishin mandatin e saj.

Në Tepelenë kish shkuar lajmi i rënies së qendrës së Prefekturës dhe, si rrjedhojë, autoritetet e kishin braktisur qytetin e Tepelenës në panik. Kjo bëri që forcat kryengritëse të hynin në Tepelenë pa asnjë lloj rezistence.

Madje në Tepelenë kryengritësit edhe drekuan. Edhe këtu u hapën depot me materiale ushtarake, u muar armatimi, u furnizuan automjetet me karburant si dhe u lajmërua administrata e nënprefekturës së Kurveleshit, me qendër në Gusmar, për kryengritjen që kish shpërthyer, duke u kërkuar bashkimin e saj me të. Në Tepelenë u bë edhe organizimi i forcave kryengritëse, të cilat arritën deri në 300 veta, duke u ndarë në kompani. Vetëm nga Kurveleshi u rreshtuan në ato kompani 64 veta, nga të cilët 28 qenë nga fshati Progonat⁴⁾. Komandantë kompanish u cakuan Tajar Goxho, Ruzhdi Golemi, Bejkush Gjoleka, etj., ndërsa komandant i gjithë forcave kryengritëse u emërua Xhevdet Gjoleka, ndërsa zëvendës (adjutant) i tij Xhelal Shtëpani.

Autokolona filloi të marshojë nga Tepelena në drejtim të Vlorës pa hasur në ndonjë rezistencë. Në anën tjetër të lumit Vjosë organet qeveritare e ndiqnin me frikë dhe panik lëvizjen e saj. Njoftonin në vijimësi Tiranën, duke kërkuar edhe përforcime, por kurrësesi nuk morën guximin të vepronin. Qendrat e komunave gjatë rrugës Tepelenë-Sevaster-Vlorë ishin boshatisur nga administrata dhe kudo kryengritësit gjenin popullin që i priste. Pati edhe ndonjë xhandar të veçuar që hodhi ndonjë pushkë, por edhe ato ishin shkrepie në ajër dhe jo në drejtim të kryengritësve. Kur kryengritësit mbritën në Sevaster, te burimet me ujë të ftohtë, ata qëndruan jo më shumë se një çerek ore për t'u freskuar, për të pirë nga një kafe si dhe për të marrë ndonjë informacion të mundshëm për rrugën që kishin përpara. Në Sevaster gjetën gati 100 burra të mbledhur te Rrapi, të cilët

⁴⁾ Rami Memushi "Histori e Kurveleshit", Tiranë, 2004, f.467

shprehën gatishmërinë të bashkoheshin me kryengritësit. Mirëpo nuk kish as makina që të transportoheshin dhe as armë të mjaftueshme për t'i armatosur dhe, si rrjedhojë, vullnetarët e grumbulluar në Sevaster nuk mundën të inkuadroheshin në kollonën që marshonte drejt Vlorës.

Gjatë qëndrimit në Sevaster u thanë se nuk ishin vënë re lëvizje të forcave qeveritare, ndërsa për Vlorën qarkullonte një lajm se atje kish shpërthyer kryengritja. Më pas mbriti një lajm tjetër se gjoja edhe qyteti i Vlorës kish rënë në duart e kryengritësve. Të dy këto lajme ishin të rreme, të përhapura nga organet qeveritare për të dizinformuar kryengritësit me qëllim që t'u hiqte vigjilencën. Por, nga ana tjetër, ato lajme i mobilizuan dhe i trimëruan edhe më shumë kryengritësit, duke u dhënë më tepër guxim dhe siguri për të vijuar rrugën drejt Vlorës, por, ama, duke qenë shumë të shkujdesur.

Rënia e Vlorës do të qe për kryengritësit njësoj si dikur në Francë rënia e Bastijës, që do të thotshte çelësi i suksesit dhe i fitores. Ndaj dhe kolona u vu shpejt në lëvizje. Por, për fat të keq të saj, këto qenë kilometrat e fundit të kryengritësve. Me të arritur kolona në Qafën e Pllaçës, kundër saj shpërtheu papritur një zjarr i dëndur e i pandërprerë. I pari mbeti i vrarë Tasim Toto, vëllai i Et'hemit. Përplasja me armë midis forcave kryengritëse dhe atyre qeveritare zgjati një orë, 20.00 - 21.00 dhe, duke qenë se forcat kryengritëse ranë në pritë dhe nën një zjarr të befasishëm, në kushtet e fillimit të errësirës, ku edhe terreni ishte i zhveshur dhe pamundësi për të organizuar mbrojtje e maskim, bëri që ata të zbrisnin nga makinat gjithë panik dhe, duke shfrytëzuar kushtet e errësirës u munduan të zinin pozicione ku të mundnin. Mirëpo

befasia e goditjes, paniku dhe errësira bënë të pamundurën që të organizoheshin, madje, duke mos u orientuar dotë si rrjedhojë e territ që sa vinte e bëhej më i errët dhe e mosnjohjes së terrenit, pati edhe nga ata që qëllonin gabimisht njeri-tjetrin. Forcat qeveritare i kishin zënë pozicionet me kohë, duke e studjuar terrenin dhe zgjedhur mirë pozicionet e luftimit, pasi edhe komandanti i tyre ishte nga ajo zonë. Pas dy orë luftimesh, ku pati të vrarë e të plagosur nga të dy palët, kryengritësit u shpërndanë, duke iu ngjitur të përpjetës së Malit të Bardhë dhe, pasi dolën nga rrezet e zjarrit të armëve të pritës qeveritare, u shpërndanë nëpër Malësinë e Kurveleshit.

Pas përpjekjes së Plloçës filloi faza e dytë, ndjekia e kryengritësve të shpërndarë në grupe nëpër Malësinë e Kurveleshit e më gjerë. Grupi Et'hemit ndoqi intenerarin Vërnik-Bolenë-Kuç-malet e Golëmit; grupe të tjerë kryesorë qenë ai i Ismail Gjylbegut, Tajar Goxhos etj., që shkuan në drejtim të Vërnikut. Grupi i Ismet Totos i doli forcës qeveritare nën vete dhe arriti të strehohej në pyjet e Kudhësit të zonës së Himarës. Ky grup përbëhej prej Ismet Toto, kapiteni i parë Xhevdet Gjoleka, togeri Bejkush Gjoleka, Xhelal Shtëpani, Murat Bardhi, Idajet Hajno, Teki Kolaneci dhe Mato Qendro. Gjatë qëndrimit në Kuç, Xhevdet e Bejkush Gjoleka u vranë nga spiunët e Zogut Hodo Bardhi dhe Ruzhdi Lamja, ndërsa Ismeti vet i pestë nuk ndaluan në Kuç, por u hodhën në zonën e Himarës, ndaj dhe agjentët e Zogut nuk mundën t'i vrisnin. Vrasësi Hodo Bardhi pasi kreu krimin shkoi në Selanik, por atje e arriti dhe e vrau Idriz Jazo⁵⁾.

⁵⁾ Bardho Hysenaj "Histori e Labërisë", Tiranë, 2011, f. 504

Forcat e shumta ndjekëse u shpërndanë pothuajse kryesisht në të gjithë Malësinë e Kurveleshit, duke zënë stanet, burimet e ujit të pijshëm dhe të gjitha pikat strategjike nga mund të kalonin kryengritësit. Ai që drejtonte forcat ndjekëse ishte një kurveleshas që e njihte terrenin mirë. Për kapjen gjallë ose të vrarë të Et'hemit dhe të Ismet Totos u shpall si shpërblim një shumë e madhe të hollash nga qeveria e Tiranës. Gjithashtu u bllokuan vijat kufitare me Jugosllavinë dhe Greqinë si dhe bregdeti, megjithëse shtetet fqinjë deklaruan se nuk do të pranonin në territoret e tyre asnjë kryengritës. Kur disa prej kryengritësve e kaluan kufirin me Jugosllavinë, u detyruan të ktheheshin. Më 19 Maj u kap Ismail Gjylbegu dhe grupi i tij; më 24 Maj u vra nga forcat ndjekëse Tajar Goxho, më 25 Maj u rrethua grupi i Et'hemit në malin Zagjeçit të Golëmit. Vareja e Zagjeçit i ngjan një koni me kulm të përmbysur me faqet e veshura me shkure. Në kulmin e këtij mali në formë koni u imponua të mbrohesh Et'hemi, i shoqëruar nga golemasi Rexho Hasani (Nikolli) dhe disa golemas të tjerë: Avdi Nikolli, Hasan Taka, Xhelo Levendi⁶. Ata e panë që po rrethoheshin dhe i ndiqnin lëvizjet e tyre duke i parë me dylbi forcat qeveritare. Kishte pak ose aspak shpresë shpëtimi. Pozicioni i tyre ishte krejt i papërshtatshëm. Po rrethoheshin nga të gjitha anët e kreshtës së Zagjeçit. Në këto çaste organizatori dhe udhëheqësi i kryengritjes, Et'hemi Toto, shkroi testamentin e tij. Pas një orë e gjysëm luftimesh Et'hemi mori dy plagë të lehta, një në dorë e tjetrën në kofshën e djathtë dhe, kur pa se rezistenca e mëtejshme ishte e pashpresë, u tha shokëve të dorzoheshin. "Mbeçi me shëndet!", Këto qenë

⁶ Abaz Goxhai "Gjurmë Golëmi", Tiranë, 2005, f. 227-228

fjalët e tij të fundit dhe, ashtu sikundër u kish thënë në Delvinë, fishekun e fundit të revolverit e kish ruajtur për vete. Kjo ishte edhe krisma e fundit e Kryengritjes së Delavinës. Vendi ku u vra Et'hemi prej atëherë i thonë "Gërçi i Hetemit"

Ismet Toto me të marrë lajmin se i vëllai ishte vvarë, u dorzua vetë në Himarë. Ai nuk e pranoi ndihmën që i afruan himariotët për ta hedhur fshehurazi në Korfus. Dhe këtë e bëri pasi e ndjeu për detyrë që të mbronte para gjyqit idealet e kryengritjes, të cilën e bëri me një mënçuri dhe burrëri të lakmueshme, duke tronditur edhe kundërshtarët e tij.

Autoritetet qeveritare gjetën qetësi vetëm si u dha lajmi për vrasjen e Et'hemit. Shpërthimi i kryengritjes kishte shkaktuar panik e alarm të madh në të gjithë Mbretërinë. Ishin vënë në gatishmëri gjithë forcat ushtarake dhe ato të xhandarmërisë, ishin mobilizuar rezervistë e automjete dhe civilë të tjerë nga Shkodra, Korça e gjer në Berat e Vlorë. Komandanti operacionit, Bilal Nivica, në telegramin që i dërgonte Ministrit të Brendshëm, midis të tjerave i shkruante: "*Detyra ime mbaron kur të kapet Et'hemi*", ndërsa pas vrasjes së Et'hemit, Ministri i Brendshëm do të urdhëronte që trupi i pa jetë i Et'hem Totos të çohet për varrim në Gjirokastër, me qëllim që të shihej prej gjithë popullit. Aq sa i madh kish qenë paniku mes qeveritarëve kur erdhën lajmet e para për shpërthimin e kryengritjes dhe marshimin e majorit me zemër të hekurt drejt Vlorës, po aq i madh qe gëzimi dhe hareja ndër qeveritarët për dështimin e kryengritjes, të cilën e festuan duke derdhur shampanjën lumë në sallonet e larta të kryeqytetit.

Pas shtypjes së kryengritjes u ndërmorrën reprezalje

të ashpra. Menjëherë u ngrit në Gjirokastrë gjyqi i posaçëm për fajë politike. U akuzuan si të pandehur 201 vetë dhe prej tyre 158 u dënuan, nga të cilët Ismet Toto me varje në litar, Ismail Gjylbegu, Ismail Shtëpani dhe Ramadan Muhameti me pushkatim, katër të tjerë me burgim të përjetshëm (me 101 vjet burg) dhe të tjerët me burgime të ndryshme. Të gjithë të dënuarit do të bënin së bashku 983 vite burg. Mbreti Zog, në një letër të posaçme i tërhiqte vemendien kryeministrit që administrata shtetërore u gjet në befasi dhe urdhëronte që të rritej edhe më shumë mbikqyrja që të mos ndodhnin më ngjarje të tilla. Me një fjalë, duhej të rritej edhe më shumë diktatura dhe roli policor i shtetit.

2. Pasqyrimi i kryengritjes nga shtypi vendas

Qëndrimi që mbajti shtypi shqiptar i asaj kohe ndaj asaj kryengritjeje tashmë është i njohur. Letra urgjente nisur tërë redaksive të gazetave dhe revistave prej Ministrisë së Punëve të Brendshme, në të cilën urdhëroheshin që Kryengritja e Delvinës të vlerësohej si një "kryengritje bolshevike", gjeti një pasqyrim të gjerë në shtypin e asaj kohe. Gazeta "Jeta e Re" e Vlorës theksonte se "Et'hem Toto i shtyrë verbërisht prej një megallomanie ambicioze..., shkeli besën e shqiptarit, prishi thesarin e trashëguar që na e kish zili bota." Sipas kësaj gazete "Kominterni me Et'hem Toton punonin, syri i Zogut përgjonte dhe vëzhgonte... Zogizma do përgjigjet kurdoherë "gati" kontra cilitdo armik"⁷.

⁷"Jeta e Re". Nr. 12. 24. Maj 1937

Ndërkaq revista "Përpjekia", në Nr.8 të saj të atij viti shkruante: "Mbi skemën e kësaj dore gjakatare na dalin përpara Machiaveli dhe Juda të armatosur gjer në dhëmbë duke lozur lodrat e tyre historike. Kultura, vetëm kultura është shpëtimi ynë. Kultura dhe sinqeriteti duhet të ndriçojnë edhe fushën e veprimit politik të një kombi"⁸.

3. Disa hollësi mbi planin e kryengritjes

Kryengritja e Delvinës u organizua nga vëllezërit Toto brenda 15 ditësh. Ismeti tregon se në një nga shëtitjet e zakonshme të të dy vëllezërve në Delvinë, Et'hemi i njoftoi vendimin e prerë që kishte marrë. Pas kësaj hynë në anën teknike të përgatitjes së kryengritjes. Tashmë ne e njohim këtë plan dhe tërë hollësitë teknike të saj. Po pse brenda një kohe kaq të shkurtër? Së pari, këtë kohëshkurtësi e presupozon mënyra e organizimit dhe e zbatimit të kryengritjes, që, nëse mund të shprehemi kështu, duhej të kishte shkrepëtimën e një blici ose të një rrufeje. Këtu qëndronte edhe një nga shanset e mundshme të suksesit të saj.

Kishte edhe shkaqe të tjera pse u shpejtua në shpërthimin e saj. Nga bisedat e Et'hemit me Ismetin mësojmë se ai mendonte se pas vizitës së Kontit Çiano në Shqipëri, jeta e kabinetit qeveritar në fuqi do të ishte e gjatë dhe nuk kishte ndonjë shpresë që mbretëria të shkëputej prej forcave të vjetra konservatore, të cilat për Et'hemin e "kishin mbyllur qarkun historik". Gjithashtu

⁸ Revista "Përpjekia, Nr. 8, Maj 1937

“hekuri duhej të rrihej sa ishte i skuqur”. Me rënien e kabinetit të Mehdi Frashërit pakënaqësia që shtuar jo vetëm në popull, por edhe në rrethet përparimtare intelektuale ushtarake e shtetërore. Iluzionet ishin shkelur me këmbë dhe çdo rreze shprese ishte shuar përfundimisht.

Veç këtyre, Et'hemit i që caktuar që ai vetë të shkonte për një kurs në Itali. Dhe ai kish bindjen se kjo bëhej, në mos për ta eliminuar me ndonjë atentat, të paktën të ishte sa më larg politikës së vendit. Me një fjalë, të gjitha rrethanat, sipas Et'hemit, diktonin që kryengritja të niste sa më shpejtë.

Drejtuesit e kryengritjes synonin të arrinin në Vlorë para se të mbrinin atje forcat qeveritare dhe do të kishin një fuqi të armatosur prej 300 veta, pa llogaritur ato forca që do të grumbulloheshin në Vlorë nga të dërguarit e tyre. Pastaj forca goditëse e kryengritjes do të vinte duke u rritur gjithnjë e më shumë. Ishin menduar edhe njerëzit me të cilët do të mund të realizohej goditja e rrufeshme pa shumë gjak e përpjekje. N/toger Tajar Goxho ishte në dijeni që në fillim për organizimin e kryengritjes dhe, me anën e tij si Rreth-Komandant i Delvinës, Et'hemi kishte në dorë tërë xhandarmërinë e nën/prefekturës, ndaj dhe Delvina u mor pa vështirësi në dorë të kryengritësve.

Njeriu tjetër që do të loste një rol shumë të rëndësishëm në realizimin e planit të kryengritjes ishte kapiteni i parë Ismail Gjylbegu, zëvendës Qark-komandanti.

Për Vlorën e largët ishte zgjedhur Ago Shero (Ago Agaj), njeri me ndikim dhe kulturë perëndimore. Ai u nis për në Vlorë që më 11 Maj, me qëllim që të mblidhte një forcë për të ruajtur autokollnën e kryengritjes gjatë

rrugës Tepelenë – Vlorë. Ditën e kryengritjes ai do të ndërpriste linjën telefonike Vlorë – Tiranë.

Lidhur me misionin që Et'hem Toto i pat ngarkuar Ago Agajt, për të cilin Ismeti në gjyq thotë se kryengritja “përfundoi në një katastrofë nga shkaku i tradhëtisë së Vlorës”, e ka fjalën për Ago Agaj, i cili ishte njeriu i parë që Et'hem ia besoi idenë e kryengritjes dhe me të cilin u konsultua; dhe këtë na e dëshmon edhe një nga oficerat shqiptarë dëshmitarë të kohës, pjesmarrës në Kryengritjen e Fierit, Xhelal Staravecka, i cili shkruan: “Ago Agaj po të kishte qenë i sinqertë me çështjen e Hetem Totos, jo vetëm kish mundësi ta asgjësonte atë qëndresë qeveritare (në qafën e Plloçës), por edhe sikur të mos ta kishte realizuar më parë atë punë (që të mbliidhte një forcë për të ruajtur autokollnën e kryengritjes gjatë rrugës Tepelenë – Vlorë), në kohën kur erdhi kolona e Hetemit, pati mundësi të madhe t’i fuste forcat e regjimit në mes dy zjarreve, duke i shpartalluar brenda pak minutash. Tek e fundit dhe ajo inisiativë nuk do të ishte aspak e nevojshme, po të mos tradhëtonte Ago Agaj, sepse në Qafë të Plloçës deri në Vlorë e më tutje deri në Tiranë, nuk do të kishte dalë asnjë qëndresë qeveritare kundër kolonës revolucionare. Mirëpo Ago Agaj, që ishte intrigant i përsosur, i pasinqert, komplotist kundër anës së dobët, ambicios e arrivist tej çdo kufiri, kishte nevojë për t’u bërë një ditë me atë servilizmin që përdorte kundrejt Zogut, si përfaqësor kryesor i dy prefekturave, Vlorës dhe Gjirokastrës, andaj nuk mungoi të vinte tradhëtisht në dijeni dajon e tij, Sadik Shaskën, një partizan i verbuar i Zogut, i cili çoi peshë vendin në çastin oportun kundra Hetem Totos, ashtu sikurse veprroi... Ago Agaj, për të cilin kurkush deri më sot nuk e ka çelur gojën për rolin fatal që luajti në lëvizjen e Hetem Totos me tradhëtinë që bëri, pse ajo lëvizje po të kish pasur sukses, patjetër do t’i kishte kursyer Shqipërisë dhe shqiptarëve turpin që i vari satrapi

i Matit, mbasi shqiptarët në një qeveri kombëtare dhe sidomos e kryesuar nga Hetem Toto trimi, do të kishin bërë atë histori kundër invazorit fashist që bëri Greqia kundër po atij agresori” .⁹⁾

Dhe, nëse realizohej ajo çka konkludon Xhelal Staravecka, edhe nëse ushtria shqiptare nuk do të mund të bënte atë që bëri ushtria greke kundër ushtrisë fashiste italiane, Et’hem Toto dhe kabineti i tij do të kishin nisur rezistencën e armatosur dhe me siguri që ndryshe do të kishin rrjedhur ngjarjet gjatë Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Këtë përfundim bindës e mbështesim edhe në thirrjen që ish-kryeministri i Qeverisë ku bënte pjesë Et’hem Toto, Mehdi Frashëri, i bëri popullit shqiptar në radio Tirana, ditën e 7 Prillit 1939, për të cilën edhe u arrestua e u internua nga Italianët: *“Një popull prej 44 milionë ndenjës, sulmoi sot në orën 4:30 të mëngjesit një popull prej një milion ndenjës, por që qëndron me trimëri. Armiku ka pasur katër humbje... Ndoshta armiku do ta fitojë luftën, por do të marshojë mbi kufomat e shqiptarëve. Burra dhe gra, popull i botës ngrihuni kundër barbarëve modernë se nesër do të jenë rrezik për të gjithë, por do të jetë vonë. Ajo që na ngjet ne sot, do t’u ngjasë të tjerëve nesër.”¹⁰⁾*

Element tjetër që zbatuan me rreptësi organizatorët e Kryengritjes së Delvinës ishte sekreti. Et’hemi kishte përvojën e Organizatës së Vlorës dhe të Kryengritjes së Fierit, që u zbuluan nga agjentët e Zogut. Në detyrat e tij si ish qark-komandant, ish prefekt dhe ish Ministër i Brendshëm e njihte mjaft mirë rrjetin e dëndur të informatorëve të monarkisë, që, siç ironizonte ai, kryetarët e komunave, nënprefektët, prefektët

⁹⁾ Shih Xhelal Staravecka “Përpara gjyqit të Historisë”, Tiranë, 2012, f.124.

¹⁰⁾ “Gazeta e Korçës”, 7 Prill 1939, pasqyruar te “Gazeta shqiptare”, 2 Dhjetor 2014.

s' merreshin me gjë tjetër, veçse dërgonin raporte sekrete - kush e kush t'i vërtetonte Mbretit se ishte përkrahësi i tij më besnik. Për këtë arsye u mbajt i kufizuar rrjeti i kryengritjes brenda qarkut të Gjirokastrës, pasi Et'hemi kishte bindjen se, po të hapej më tej, rregjimi do të binte në gjurmë. Aq më keq kur ai vetë ishte gjysëm i internuar dhe nën vëzhgimin e oligarkisë zogiste. Kështu që edhe disa prej bashkëpuntorëve të tij më të rëndësishëm, si Ismail Gjylbegu, Xhevdet Gjoleka etj., ua njoftoi planin e kryengritjes pak ditë para shpërthimit të saj ose, në ndonjë rast, dhe ditën e fundit, duke u shfajësuar para tyre se këtë e kërkonte e mira e organizatës.

Dita e shpërthimit të kryengritjes u caktua për ditën e Shtunë, që në Delvinë ishte ditë pazari, me qëllim që të mos binin në sy ata që ishin thirrur të vinin nga larg. Veç kësaj, kur Et'hemi duhej të lajmëronte me anë të letrave dhe fonogrameve shokët për të ardhur në Delvinë, krijoi legjendën se i thërriste për t'u takuar meqë do të shkonte në Itali dhe kjo s'kish se si të mos besohej, pasi dihej zyrtarisht dhe ishte bërë edhe publike. Duhet thënë se këto dy elementë të kryengritjes, fshehtësia dhe befasia, çuan vënien shumë shpejt nën kontroll të Gjirokastrës pa asnjë gjakderdhje dhe rezistencë të madhe.

Është për t'u theksuar që, nëse kryengritja ishte disi e kufizuar në përhapje territoriale të rrjetit të saj, nga pikpamja e pjesëmarrësve aktivë, të cilët ishin kuadro ushtarakë, ajo përfshinte gjithë gjeografinë e Shqipërisë, që nga Tropoja, Puka, Kukësi, Shkodra, Tirana, Përmeti, Gjirokastra, Delvina, Saranda, Konispoli, madje edhe nga Kosova e Çamëria. Disa nga udhëheqësit e saj kryesorë, si Gjylbegu e Shtëpani, ishin njëri nga Shkodra e tjetri nga Tirana.

Duhet vënë në dukje se gjatë kryengritjes Zogu nuk u atakua. Kur Et'hemi e pa të varur fotografinë e Zogut në ndërtesën e Prefekturës së Gjirokastrës tha "s'kemi punë me Mbretin". Po kështu iu përgjegj edhe një ushtaraku që shprehu besnikëri ndaj sovranit, sikundër del nga deponimet në gjyq. Ismeti në fjalën e mbrojtjes dhe në deponimet e tij mohoi se kryengritja ishte kundër mbretit, madje e shpalli të vëllanë besnik të mbretit gjer në frymën e fundit. Në fakt duket se ky ka qenë një veprim taktik i paramenduar nga udhëheqësit e kryengritjes: luftë kundër monarkisë pa e përmendur monarkun sepse ai kishte ndikimin e tij dhe do të ishte e parakohëshme dhe e dëmshme për kryengritjen. Duket se ata e kishin gjykuar se do të ishte më e dobishme të përdorej taktika që fajtorët ishin ata që rrethonin mbretin, të vjetrit, konservatorët, qeveritarët e pa aftë, të korruptuar e tiranë. Madje, kur të merrnin Vlorën, Et'hemi do t'i telefononte mbretit që ky të pranonte kushtet e kryengritjes.

Më këtë taktikë, Kryengritja e Delvinës ka shumë përqasje me atë të Ataturkut në revolucionin turk. Siç dihet, prijësi turk në fillim hyri në marrëveshje me Sulltanin për ta tërhequr këtë në rrugën e reformave dhe, kur e pa se një lidhje e tillë ishte e pashpresë, Ataturku priti rastin e volitshëm për të organizuar kryengritjen. Edhe kur ajo filloi në Anadoll, sulltani nuk u atakua, duke marrë parasysh ndikimin e ndjeshëm që kishte jo vetëm në popull, por edhe në rrethet e kryengritësve. Edhe kur u vendos administrata e pavarur nga pushteti i sulltanit në Ankara, sërish sulltani nuk u atakua, por u quajtën fajtorë ata që e rrethonin dhe keqinformonin.

Pothuaj kjo linjë u ndoq edhe nga vëllezërit Toto. Et'hemi orvatjen e parë për ta tërhequr Zogun me forcat

e reja politike reformiste e kish bërë në një audiencë me të, ku i ishte shprehur hapur dhe kishte marrë premtimin e tij. Kur pa se Zogu kaloi në anën e kundërt, Et'hem organizoi Kryengritjen e Delvinës dhe deklaroi se revolucioni kishte për qëllim rrëzimin e kabinetit që kishte një program të keq. Pra, duket qartë ndikimi që ka pasur revolucioni turk, madje "Të rinjtë" e kishin deklaruar disa herë se për një revolucion të tillë kishte nevojë dhe Shqipëria.

Në Vlorë do të fillonte faza e dytë e kryengritjes, po qe se nuk do të pranoheshin kushtet e tyre. Duke zotëruar dy qarqe, atë të Vlorës dhe të Gjirokastrës, kryengritësit do të krijonin një front nga Ura e Mifolit dhe gjatë gjithë rrjedhjes së majtë të lumit Vjosë. Duke njohur mirë pozicionet e forcave antizogiste, disa prej personaliteteve të larta civile dhe ushtarake, si dhe pakënaqësinë e përgjithshme nga gjëndia e vështirë në të cilën ndodhej vendi, Et'hem shpresonte se do të pasohej dhe nga të tjerë. Emrat e Dine Hoxhës, Muharrem Bajraktarit, Sali Manit, Kolë Bibës, Gjon Markagjonit, Maliq Bushatit, Kadri Hoxhës, Skënder Çamit etj., të cilët, për të ngritur moralin ia paraqiste bashkëpuntorëve të tij sikur kishin lidhje direkte me kryengritjen, në të vërtetë ishin vetëm fuqi e mundshme. Po qe se nuk do të realizoheshin parashikimet e tij dhe ai do të mbetej i vetëm përballë forcave zogiste, Et'hem atëherë mendonte se do të kishte pak shpresë për fitore, por sidoqoftë ia vlente të luftohej. Popullit shqiptar duhej t'i jepej një shembull se Shqipëria nuk ishte as "teqe", as "manastir" dhe as çiflik i një grupi sundonjësish, të cilëve u kish perënduar koha.

Ndërsa për vënin në zotërim të Delvinës, Gjirokastrës dhe Tepelenës taktika që ishte përzgjedhur u vu në zbatim plotësisht, nuk ndodhi kështu në marshimin drejt Vlorës. Plani ishte që të arrihej atje në ora tre të pasdites të së nesërme së shpërthimit të kryengritjes në Delvinë, çka nuk u realizua për shkak të disa vonesave të pajustificueshme, si ajo në Tepelenë dhe në disa fshatra e komuna gjatë rrugës, pa harruar ato që ndodhën në Gjirokastër.

Më e keqja ishte siguria me të cilën lëvizte autokolona gjatë marshimit drejt Vlorës, me një shkujdesje dhe guxim gati të verbër. Një njeri i vetëm, i dërguar në fshatrat e Vlorës që në 11 maj, vetëm katër ditë më herët se të shpërthente kryengritja, duke lëvizur vetëm në këmbë fshat më fshat, rrugë e parrugë, për të prerë linjën telefonike me Tiranën dhe për të siguruar rrugën me anë të njerëzve që do të mund të mblidhte, ishte pak për të qenë një bazë sigurie, edhe sikur të ishte tepër besnik dhe shumë i vendosur. Aq më tepër kur prej ditës që ai ishte nisur, nuk ishte realizuar as edhe një lidhje me të.

Të mrrshoje pa pararojë ishte një gabim tjetër fatal dhe foshnjarak i udhëheqjes së kryengritjes.

Edhe ideja për të organizuar një rezistencë në Malësinë e Kurveleshit pas disfatës së Ploçës, nuk mund të realizohej. Jo se mungonte pakënaqësia në këtë krahinë, që vuante nga uria kronike, por ngaqë nuk ishte përgatitur terreni për një veprim të tillë të paparashikuar më herët. Natyrisht që goditja shkatërruese e Ploçës ishte vendimtare në prishjen e planit taktik të kryengritjes.

4. Rrethanat historike, mendimi social-politik i Kryengritjes së Delvinës dhe shkaqet e dështimit të saj.

Për çdo ngjarje historike të madhe ose të vogël, në thelb s' mund t'u shmangesh tri pyetjeve kryesore: Kur?, Ku? dhe Si? lidhur me Kryengritjen e Delvinës nuk është e lehtë t'u përgjigjesh këtyre pyetjeve, edhe pse ajo ka ndodhur gjatë regjimit zogist, të cilit historiografia e jonë ende nuk i ka bërë një analizë serjoze dhe të paanshme. Do të përpiqemi të parashtrojmë, aq sa na jep mundësia e kësaj analize, rrethanat historike, mendimin social-politik, si dhe motivet që shtynë shpërthimin e kryengritjes; çfarë mundi të arrijë e çfarë jo.

Kryengritja e Delvinës, sikurse edhe ajo e Fierit, pati një jetë shumë të shkurtër. Është edhe kjo një prej arsyeve që të mos kemi një dokument programatik të lëshuar direkt prej saj. Megjithatë kjo nuk do të thotë se kryengritja nuk pati programin e vet. Vetë veprimtaria e kryengritjes, proceset e hetuesisë, fjala e njohur e Ismet Totos në gjyqin politik dëshmojnë për këtë. Kur Et'hem Totos i duhet të lëshojë një dëftesë për disa të holla për nevojë të kryengritjes në Gjirokastrë, nënshkruan nën cilësinë "*Komandant i kryengritjes çlironjëse*" (korsivi është i yni, H.Q. I.G), ndërsa në testamentin, që ka lënë para vetëvrasjes në mal të Golëmit, gjenden këto dy fraza kryesore: "..., poshtë tirania, rroftë nacionalizma" dhe, si gjithnjë, kur ka folur e shkruar gjatë kryengritjes, e ka quajtur atë "revolucion". Pra, një revolucion çlironjës kundër tiranisë, një revolucion nationalist. Këto ide të lëna me shkrim nga udhëheqësi kryesor i kryengritjes, përputhen me parashikimin e ideve të Ismet Totos, i cili,

në të vërtetë, ishte ideologu i saj.

Kryengritja ishte përpjekia e fundit për vënien në jetë të programit të vëllezërve Toto, veprimtaria dhe mendimi i të cilëve ka pasur ecurinë e vetë. Para se kryengritja të shpërthente, ajo ka fazën e vet legale e paqësore, sidomos gjat vitit 1936, me shkrimet e Ismet Totos me karakter letrar, publicistik, politik dhe filozofik. Madje Ismet Toto shpalli botërisht edhe formën më të përshtatëshme të regjimit që mendonte ai për Shqipërinë e kohës. Po kështu, edhe në veprimtarinë e tij si personalitet shtetëror, sidomos në raportin që ka lënë Et'hem Toto pas vizitës së tij në Shqipërinë Jugore, kur ai ishte ministër i brendshëm, jepet një ide e karakterit dhe e synimeve të Kryengritjes së Delvinës.

Në fjalën e tij mbrojtëse në gjyq Ismeti thotë se Kryengritja e Delvinës u zhvillua me mjete dhe njerëz të regjimit dhe ai ka parasysh personalitetet kryesore të kryengritjes si: Et'hem Toton si ministër i punëve të brendshme; kapitenin e parë Ismail Gjylbegun si qark-komandant i xhandarmërisë; nëntogerin Tajar Goxho si rreth-komandant i Delvinës, toger Xhelal Shtëpanin si kryetar i zyrës së rekrutimit në nën-prefekturën e Sarandës, etj.

Është konstatim i një dukurie të zakonshme fakti që regjimet janë brejtur nga brenda dhe se disidenca ka qenë produkt i pashmangshëm i dekompozimit të tyre. Ndaj dhe në rastin tonë pyetja më e natyrshme që lind është kjo: kur dhe pse u krijua opozita e vëllezërve Toto me regjimin? Ose, më saktësisht: çfarë i lidhi dhe çfarë i ndau ata me Zogun?

Zogu u shfaq si një personalitet me ambicje në skenën e trazuar politike shqiptare. Pa hyrë në hollësi, mund të

thuhet se gjatë sundimit të tij 15 vjeçar, ai e konsolidoi dhe e çoi më tej strukturën e shtetit shqiptar dhe vendosi qetësinë në vend. Për krijimin e hapësirës ligjore ai u prir nga modelet perëndimore. Nuk qenë pa dobi edhe përpjekiet që ai bëri për infrastrukturën, kulturën e arsimin, në një vend që kishte trashëguar një prapambetje shekullore. Në peshoren e historisë regjimi zogist ka peshën e vet në të dyja anët e balancës.

Et'hem Toto kreu një veprim të guximshëm në grupin e Përmetit më 1924, në përkrahje të Zogut dhe shërbeu në administratën e tij për 13 vjet në detyra të larta. Asokohe në Shqipëri, megjithëse ishin aprovuar kodi penal dhe civil, të përparuar për kohën e tyre, prapëseprapë vepronte gjerësisht kanuni dhe e drejta zakonore dhe ishin ende gjallë prirjet e krahinorizmit dhe të bajraktarizmit. E. Toto që caktuar në pikat më delikate të mbretërisë dhe kishte ditur të vendoste rregullin dhe qetësinë, duke bërë emër si administrator i zoti, i guximshëm, vetveprues, parimor e i pakorruptueshëm dhe me ide reformatore. Kur ai u emërua prefekt në Dibër, administrata nuk përfillej fare, titullarët e saj tërhiqeshin prej hundësh prej bajraktarëve dhe kudo zbatoheshin kanuni. Ai brenda një kohe të shkurtër vuri në vend autoritetin e administratës shtetërore, çarmatosi popullsinë, vendosi rregullin dhe qetësinë duke e paralizuar rivalitetin e bajraqeve. Po me kaq sukses ai i drejtoi punët edhe në prefekturën e Kosovës (Kukës, Krumë, Tropojë). Në kohën që do të vihej në zbatim ligji i shtetëzimit të shkollave, ai u transferua në Shkodër, pasi gjendja atje paraqeste problem. Gjenden dokumenta ku shprehet vlerësimi i lartë i punës së Et'hemit, dhe ja seç thuhet në raport-kontrollin e Ministrit të Oborit:

“Qetësia dhe regulli... vjen gjithnji tue u përmirësue në Qarkun e Prefekturës së Kosovës. Zelli qi tregon gjindarmëria e atjeshme në rastin e çdo ngjarjeje dhe rregulli i Rojeve Mbretnore të Kufinit, kanë për efekt kufizimin e ngjarjeve të zakonshme.

Zv. Prefekti, z.kapiten Et’hem Totoja tregon një aktivitet në përmbarrimin e detyrës si në pikpamjen e mbajtjes së regullit e të qetësisë ashtu edhe në mirëadministrimin e vendit, tue veprue i pa-anshëm me një egalitet për të gjithë e tue mos pranue influencat e ndërhyrjet e zakonshme të Kryetarive e Bajraktarëve në dam të popullit”¹¹.

Qëndrimi dhe veprimi i Et’hem Totos fill pas vrasjes së majorit në rezervë Sul Shehu, e ngriti edhe më lartë autoritetin e tij. Në atë situatë të acaruar në kulm, Et’hem Toto e la revolverin në zyrën e vet dhe me shishen e rakisë dhe paketat e duhanit në xhep, shkoi në shtëpinë e të vrarit dhe, sipas zakonit të Labërisë, ngushëlloi familjen dhe të afërmit e të vrarit Sul Shehu. Veprimi i tij sa i delirë aq edhe burrëror paralizoi edhe më këmbëngulësit që kërkonin vrasjen e Et’hem Totos, i cili akuzohej si vrasësi i Sul Shehut.

Mirëpo me kohë nuk mund të mos delnin në pah edhe anët negative të personalitetit të Zogut dhe të qeverisjes së tij. Shpejt u vu re ambicja e tij për të përqëndruar pushtetin në duart e veta. Sado që Shqipëria qe shpallur “Monarki demokratike parlamentare”, në të vërtetë monarku kishte përqëndruar në duart e veta pushtetin legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor dhe ushtarak. Mjafton të përmendim se edhe emërimi i një nëpunësi të thjeshtë duhej të miratohej patjetër nga mbreti. Ishin të ndaluara partitë politike, shtypit mbahej nën çensurë dhe

¹¹ Dosja nr. 251. Fondi Kryeministria, viti 1932, fleta 7

kundërshtarët e regjimit ndiqeshin ose eleminoheshin. Arrihej gjer atje sa të miratohej një fond i veçantë nga parlamenti dhe Zogu për kryerje atentatesh politike.

Ndërkohë inteligjenca e re shqiptare që po mëkëmbej, dalëngadalë filloi të formulonte kërkesa të reja të qenësishme. Shqipëria e konsoliduar sadokudo administrativisht kishte nevojë për reforma të thella ekonomike dhe sociale. Demokratizimi i jetës së saj do të shpejtonte ecjen përpara për ta vënë në radhën e kombeve të qytetëruara. Me një fjalë, problemet e brendshme të shoqërisë shqiptare, në të gjitha rrafshet, delnin në plan të parë dhe kërkonin zgjidhje të reja zhvillimi për të ecur me ritmin që kërkonte koha.

Në studimet mbi kohën e regjimit monarkik të Zogut historiografia komuniste u ka dhënë prioritet grupimeve të jashtme si KONARE-s, KCN, "Bashkimit" dhe pak ose fare pak mendimit publicist, politik, ekonomik dhe filozofik brenda vendit. Edhe kur i ka prekur, ato i ka dhënë nën dritë të shtrembër, duke i anatemuar, duke e shpërfillur rolin e tyre në emancipimin e shoqërisë shqiptare dhe duke ngritur në qiell lëvizjen komuniste, e cila asokohe qe me peshë të papërfillshme në jetën e shoqërisë shqiptare.

Krahas qëndrimit dhe mendimit zyrtar, asokohe ka patur në Shqipëri edhe rryma të tjera, ku më e spikatur kanë qenë ajo që u quajt "Neoshqiptarizma" dhe "Grupi i të rinjve". Këta përfaqësoheshin nga intelektualë të shquar me një kulturë perëndimore. Thelbi i "Neoshqiptarizmës" ishte formimi i një ndërgjegjeje kombëtare shqiptare *si detyra më themelore që i ngarkohej asaj epoke*. Sipas neoshqiptarizmës, kjo do të arrihej me përhapjen e

kulturës, arsimit, shkencës, moralit dhe edukatës. Sipas tyre, elita drejtonjëse e kish mbyllur qarkun historik dhe duhej përtëritur. Gjithë kjo do të bëhej në mënyrë evolutive, siç shpreheshin ata, duke ecur “me ngadalë dhe me kujdes nëpër gërmadhat e jetës sonë”. Neoshqiptarizma i nisi idetë e saj me gazetën “Demokratia”, vijoi më pas me “Minerva”, “Illyria” dhe “Përpkjia shqiptare”. Ismet Totua dha ndihmesën e tij, krahas Branko Merxhanit dhe të tjerëve, me një varg artikujsh, madje në “Illyria” ishin në redaksinë e gazetës së bashku dhe me intelektualë të tjerë të shquar, si Ernest Koliqi, Odhise Paskali e Anton Logoreci.

Një degëzim i “Neoshqiptarizmës” janë edhe “Të rinjtë”, të udhëhequr nga Ismet Totua. Ata i propaganonin idetë e tyre në gazetën “Arbëria”. Ajo çka sollën të re “Të rinjtë” ishte ideja se kishte ardhur koha të bëheshin ndryshime radikale për të fituar kohën e humbur. Sipas tyre, atë që do ta realizonte për 50 vjet Shqipëria duhej ta arrinin për 10-15 vjet. Dhe kjo mund të bëhej vetëm me përparimin e kulturës, por edhe me ndryshime të thella ekonomike, nëse shtetin do ta merrnin në dorë forca të reja politike. Këtu ndaheshin pikëpamjet e “Të rinjve” me “Neoshqiptarët”. “Neoshqiptarët” parashikonin rrugën “iluministe”, kurse “Të rinjtë” e shtronin problemin për zgjidhje.

Në një shkrim të Ismetit, kur del numri i parë i revistës “Përpkjia shqiptare”, e drejtuar nga Branko Merxhani, ai shkruan: “... jemi të gëzuar që doli në dritë kjo revistë dhe urojmë të qëndroi në këmbë për shumë kohë”. Por njëkohësisht ai bën edhe disa vërejtje. “Në kopertinën e revistës është shkruar: “Politikë s’ka! Vetëm kulturë!”, që duket se është edhe

deviza e saj.

“Si mund të thuhet se s’ka politikë për një revistë që diskuton problemet bujqësore, shoqërore, psikologjike dhe filozofike?... Kur flet për “burrat e shtetit” të Tiranës që s’njohin sociologjinë... merret me politikë... dhe bën fare mirë”.

Nuk është këtu vendi për të bërë analiza të ideve të “Neoshqiptarizmes” dhe të “Të rinjve” për shumë problem të shoqërisë shqiptare të kohës. Qëllimi i këtyre ideve trajtuar në vija të trasha është ndriçimi i problemit të Kryengritjes së Delvinës, e cila pati në themel të programit të vetë kryesisht atë të “Të rinjve”. Si rrjedhojë e polarizimit të shoqërisë shqiptare, në atë kohë u vunë përballë dy pole të kundërta, dy grupime kryesore: “Të vjetrit”, që u grumbulluan kryesisht rreth gazetës “Besa”, dhe “Të rinjtë” që kishin organ kryesor “Arbërinë”. “... të vjetër janë ata turkoshakë e orientalë, që e mendojnë Shqipërinë si një farë Afganistani në mes të Evropës. Dhe “Të rinj” janë ata, që duan që kjo Shqipëri të evropianizohet sa më parë në të gjitha shfaqjet e saj morale e lëndore”¹².

Tashmë kishte kaluar koha e vendosjes së një shteti me një administratë të qëndrueshme dhe e një qetësie relative të vendit. Kur zyrtarët s’linin rast pa përmendur “qetësinë shembullore në Shqipëri”, Ismeti i ironizonte, duke shkruar: “Me forcë mund të mbahet qetësia, por nuk bëhet kombi”.

Administrata e monarkisë kishte filluar të amortizohej, të burokratizohej, të plakej e të molepsej nga korrupsioni. Zogu kishte grumbulluar rreth vetes kryesishtë servilë të tij; ekuilibrin midis forcave të

¹² Ismet Toto, *Lakra të ndara*, “Arbëria”, 21.01.1936

brendshme synonte ta mbante duke u mbështetur kryesishtë tek forcat konservatore dhe, në vendin më të varfër të Evropës, bënte në pallat një jetë tepër luksoze. Nuk u ndërmor asnjë reformë me karakter ekonomiko-shoqëror që të mund ta çonte vendin drejtë përparimit të shpejtë. Shqipëria vazhdoi të mbetej me një feudalizëm anadollak dhe me një borgjezi rakitike e të paaftë për të vënë në shërbim të vetes e të kombit pasuritë e saj. Edhe një reformë agrare që u nis, mbeti në kufij simbolikë. Ndonëse arsimi e shëndetësia patën një farë zhvillimi, ky qe i pakët. Shqipëri mbetej vendi më me shumë analfabetë në Ballkan; malarja, sifilisi dhe sëmundje të tjera bënëin kërdrinë. Po kështu edhe në infrastrukturë. Sado që aty u bënë investimet më të mëdha të huave italiane, mjetet kryesore të lëvizjes për shqiptarin do të mbeteshin gomerët, mushkat me këmbë të holla dhe karrot e dremitura të qerreve e buajve. Megjithëse Shqipëria ishte një vend bujqësor, uria bënte kërdrinë jo vetëm në zonat malore, por edhe në ato fushore. Legjenda për kokrën e misrit nuk ishte vetëm në Bjeshkët e Namuna, por edhe në Myzeqenë e Fierit.

Në një raport që i ka dhënë monarkut një inspektor i oborrit mbretëror, në mars të vitit 1938, thuhet: *“Me inspektimin që bamë ne Fier simbas urdhnit të NALTMADHNI S’UAJ konstatuem: Gjendia ekonmike e katudeve të Fierit, si të vendasve ashtu edhe të emigrantëve, asht aq e dhimbshme sa qi prek edhe zemrën ma të fortë për të derdhë lotë mbi fatkeqësinë e këtij populli. Vajza dhe djem të moshës së njomë, burra dhe gra, pleq dhe plaka e mbushnin korridorin e madh të N/prefekturës dhe sheshin para N/prefekturës me strajca dhe thasë nën sqetull, dhe me zanin e t’yne të mallëngjyeshëm kërkojnë nga autoritetet bukë! Bukë! Bujqësia dhe blegtoria në*

këto vise ka vdekë faret, ky vend qi një kohë ishte hambari i Romës së vjetër, sot ka mbet një shesh urijet”.

Intelektualët e vërtetë e njihnin gjendjen e mjeruar të popullit dhe nuk mund të pajtoheshin me të. Ismeti e ka ngritur zërin e tij me guxim dhe me një dhimbje të thellë. Ja seç shkruante ai në qershor të vitit 1936: *“Për popull shqiptar unë nuk kuptoj vetëm ata 300-400 persona të shpërndarë nëpër qytete të ndryshme të Shqipërisë, që kanë kapele në kokë, që mbajnë kravata në fyt, që vishen “allafrënga’ dhe që dinë gjuhë të huaja. Jo, unë për popull kuptoj edhe ata që rrojnë me pesëqind mijëra mundime nëpër shpella, mbi male dhe ndër fusha malarike, ata që për shtrat kanë dhenë, për jastëk gurin, ata që bukën e hanë thatë ose që e ngjyjnë me hi dhe shëllirë, ata që janë sulmuar rreptësishtë nga sifilizi, nga tuberkulozi dhe nga mijëra sëmundje të tjera, ata që nuk dinë të shkruajnë emërat e tyre...”*

Dhe s’mund të ndodhte ndryshe kur, sipas një studimi të kohës, në ekonominë shqiptare s’kishte pikësynime të qarta, kur në çdo degë të saj prodhimi ishte tepër i ulët, me një defiçit të madh buxhetor, kur ndiqej një politikë fiskale, kur të ardhurat mbi fitime nuk ishin progresive, duke privilegjuar kështu një grup njerëz të pasur; ku, sipas llogarive, e dhjeta ishte në një masë të tillë për bujkun, njësoj si t’i merrje tregëtarit gjithë fitimin, po ashtu edhe xhelepi për blegtorinë, çka jo vetëm që nuk e nxiste ritjen e prodhimit blegtoral, por e rrëronte atë; ku, në një vend që vuante nga zia e bukës së misrit, 367.000 hektarë tokë e punueshme ishte jashtë përdorimit; ku aparati burokratik rrëmbente 50 përqind të të ardhurave të buxhetit, shifër kjo më e larta në Evropë, kur limitet ishin aso kohe jo më tepër se 30-32 përqind. Një shkak me peshë në keqësimin e gjendjes së

përgjithëshme, sipas këtij studimi, ishte dhe administrata e paaftë për të zbatuar një politikë të drejtë fiskale, ekonomike dhe sociale për të shfrytëzuar gjithë potencialin pasuror të vendit.

Gjatë çdo periudhe sundimi do të ishte e padrejtë të kërkoje "çudira", por ato mundësi që jep koha dhe ato mundësi reale që ka vendi, të ndërthurura këto dhe me faktorët e jashtëm, duhen shfrytëzuar për përparimin e vendit. E vërteta është se Shqipëria gjatë sundimit të Zogut qëndroi larg mundësive të saj dhe nuk i ngushtoi sadopak dallimet, qoftë edhe me vendet fqinjë, por vazhdoi të mbetej orienti i Ballkanit, një Turqi pa turqit. Pakënaqësia ishte e përgjithshme, me përiashtim të një shtrese të privilegjuar.

Vëllezërit Toto kanë qenë përherë në radhët e forcave të reja politike. Të dy vëllezërit ishin të një mendjeje në qëndrimet dhe idetë e tyre. Kishin edhe një ndarje fushash në veprimtarinë që kryenin: njëri si statist dhe tjetri në fushën e letrave. Pikëpamjet e Ismeti janë të njohura përmes shkrimeve të shumta me karakter publicistik, filozofik dhe letrar. Ismeti e trupëzoi mendimin e tij për shtetin që i duhej Shqipërisë asokohe, me Diktaturën e Ndritur Nacionaliste ose, ndryshe, me shtetin autoritar, apo "*demokracinë e disiplinuar*", siç e quanin neoshqiptarët. Në disa shkrime të tij Ismeti bën një përshkrim të ecurisë historike të njerëzimit që nis me *demokracinë direkte*, vazhdon me *demokracinë e përfaqësuar* dhe përfundon me *shtetin autoritar*. Sipas tij, forma demokratike e kish humbur vitalitetin. Ai përkrahte diktatorët e ndritur, të cilët dallohen nga uzurpatorët që asfiksojnë lirinë dhe përparimin shoqëror. Si shembuj të diktaturave të ndritura, që i kanë sjellë njerëzimit

përparimin, Ismeti jep sundimin e Perikliut, Cezarit e Augustit në periudhën antike dhe të Duçes, Hitlerit, Leninit dhe Ataturkut në kohën e tij. Siç shihet, Ismeti nuk niset nga ideologjitë, por nga një formë e caktuar sundimi. Diktaturën e Ndritur Nacionaliste Ismeti e quante të domosdoshme që kombi shqiptar të shkundte pluhurin orientalist dhe prapambetjen e thellë. Ideja e shtetit autoritar, që do të ishte mishërimi i interesave të larta kombëtare.

Si e mendonte Ismeti strukturën e saj? Një parlament që *“të ketë një ngjyrë të fortë patriotizmi aktiv... duhet që shumica e deputetëve të jenë profesionistë në degë të ndryshme. Për shembull, 7-8 nga juristët më të mirë që kemi, 7-8 ekonomistë, grupe të vegjël inxhinjerësh, agronomësh, dijetarësh, shkrimtarësh, gazetarësh etj. Me pak fjalë, kur të vejë në Parlament një objekt, ai të bjerë në duar kompetentësh që dinë ç’thonë, ç’duan e ç’bëjnë. Në Parlament të sundojë një frymë përparimtare në shkallën më të lartë”*¹³. Kurse ekzekutivi, sipas Ismetit, duhej të përfaqësohej *“me një qeveri të fortë nacionaliste... një qeveri tejshikonjëse, përparimtare, energjike dhe patriote, që për finale të ketë të ardhmen e kombit... Kam qenë dhe gjithmonë do të jem kundra despotizmit dhe absolutizmit të kohës të para 21 Tetorit (24 tetor 1935 vjen në fuqi kabinti i Mehdi Frashërit – shënimi ynë) s’kam qenë, s’jam e s’do të jem kurrë kundër lirisë në kuptimin inteligjent të kësaj fjale. Dhe për të zhdukur gjurmët e asaj kohe fatale dhe për të përgatitur turmën që të kuptojë dhe të shijojë lirinë, është e nevojshme që të vendoset sot në Shqipëri Diktatura e Ndritur”*.

Realitetin shqiptar Ismeti e gjente në përqasje me Turqinë dhe Diktaturën e Ndritur Nacionliste e shihte

¹³ Ismet Toto, *Parlamenti i nesërm*, “Arbëria”, datë 31.01.1936

të ngjashme me tipin e shtetit që ndërtoi Ataturku në Turqi. Jo rastësishtë ai shkroi biografinë e njohur për Ataturkun dhe ia kushtonte atë “Brezit të ri shqiptar që po ngrihet”. Ai kërkon në krye të shtetit shqiptar një udhëheqës të tipit të Ataturkut, që të ngrinte popullin e përgjumur dhe të ndërmerre reforma radikale në këtë “shoqëri të kalbur”, për t’i shkukur rrënjët feudalizmit, patriarkalizmit dhe mentalitetit oriental dhe për ta evropianizuar tërësisht e rrënjësisht shoqërinë shqiptare. Ismeti do të shprehej kështu:

“Ne duam që brenda një çerek shekulli t’i arrijmë dhe t’i kalojmë popujt që na rrethojnë. Këtë nuk do ta arrijmë dot as për pesë shekuj në qoftë se në këtë vend nuk do të dominojnë në një mënyrë supreme parimet dhe fryma e botës së perëndimit”.

Me ardhjen në fuqi të kabinetit të Mehdi Frashërit, tek Et’hem i lindi shpresa për një kthesë të politikës zogiste dhe Ismeti nuk i kurseu në atë kohë lavdërimet për Zogun. Por njëherësh nuk i rreshti kritikën e ashpra kundër të vjetërve për gjendjen gati mesjetare të Shqipërisë. Ky paradoks nuk mund të mos i binte në sy mbretit. Dhe qeverinë e kryesuar nga Mehdi Frashëri vëllezërit Toto e shihnin si një periudhë tranzicioni. Ismeti, në një artikull e quante “as të zezë e as të bardhë”. Madje lufta midis “Të vjetërve” dhe “Të rinjve” do të vazhdonte të ishte e ashpër dhe pa kompromis, jo me një fitore të menjëhershme, ndoshta edhe me disfatë. *“Fryma oksidentale nuk mund të hedhë rrënjë në Shqipëri pa çkukur ajo e Orientit Dhe Orienti nuk çkulet pa përpjekje, bile përpjekje të forta. Në këtë pikë është koncentruar syri i popullit. Kjo betejë në mes t’Oksidentit dhe t’Orientit mund të tërheqë interesin e popullit t’onë apatik në lëmin e punëve dhe çështjeve kombëtare... Ndonjë gjysëm i vjetër do të na thotë: Kjo është*

disarmoni! Ne i përgjigjemi me një "PO" të fortë dhe i themi se Shqipërinë nuk e kemi përfytyruar kurrësi një teqe dhe një manastir ku çdo gjë është e qetë... dhe e vdekur. Ne e mendojmë dhe e duam Shqipërinë një vend lartësisht të gjallë dhe të fuqishëm, një vend ku konkurenca dhe përpjekia për t'u lartësuar në të gjitha çfaqiet e jetës të jetë me të vërtetë e fortë dhe e rrëmbyer"¹⁴⁾.

Ky ka qenë dhe vizioni i Et'hemit për të ardhmen e Shqipërisë, çka duket dhe nga raporti që i paraqiti Et'hemi Zogut gjatë një vizite në Jug të Shqipërisë. Ai vë në dukje gjendjen e rëndë në të gjitha prefekturat që vizitoi. Propozimet që ai bën për të dalë nga kjo gjendje rrokin gjithë problemet themelore që shqetësonin shoqërinë shqiptare. Et'hemi propozon zgjerimin e infrastrukturës, bonifikimet në bujqësi, rritjen e rendimenteve bujqësore, hapjen e vendeve të punës duke u gjallëruar dhe disa degë tradicionale të ekonomisë, shfrytëzimin e disa qendrave turistike, ngritjen e qendrave social-kulturore, përmirësimin e urbanistikës së qyteteve dhe rritjen e ndjenjës nacionale, sidomos kundër reaksionit verio-epirot në zonën kufitare, spastrimin e administratës në prefektura, nënprefektura e komuna nga nëpunësa të korrumpuar e të paaftë. *"Ne do të përpiqemi energjikisht po qe se sovrani jonë do të disponojë një përkrahje intensive"*, shton ai.

Në një nga audiencat me Zogun Et'hemi, duke i shprehur besnikërinë e tij, i kërkon të mos sjellë të vjetrit prapë në fuqi se kjo do të shkaktonte një dëshpërim të thellë në gjithë popullin. Megjithëse Zogu i përgjigjet:

¹⁴⁾ Ismet Toto, *Një parathënie*, Arbëria, 09.01.1936

“Et’hem, kam flokë të bardhë në politikë, nuk baj unë të tilla gabime”, ai nuk u shkëput dot nga konservatorët, ku mbështeti politikën e tij dhe drejtimin e shtetit, ndërsa forcat me ideale të reja i vuri në shënjestër. Et’hem Totua bënte pjesë ndër këta politikanë dhe gjysëm i internuar u vendos në Delvinë. Nuk duhet menduar asesi që opozita e Et’hemit me Zogun nis këtu. Ajo është më e hershme.

Dështimi i vëllezërve Toto natyrisht që ka shkaqet e veta. Ismeti, duke dashur të gjente shkaqet e këtij dështimi, do të shkruante se kryengritja *“përfundoi në një katastrofë nga shkakut i tradhëtisë së Vlorës dhe ngaqë që më tepër një akt dëshpërimi të thellë, sesa një kryengritje e përgatitur teknikisht dhe siç duhet”*.

Për të zbuluar shkaqet e dështimit të Kryengritjes së Delvinës duhet shikuar në një hapësirë më të gjerë, që ze tërë periudhën historike të sundimit zogist. Fati i saj nuk ishte i veçuar, por i paraprirë dhe nga disfata të tjera të mëparshme që pothuaj patën të njëjtin fund.

Tri janë goditjet kryesore që u ndërморën kundër regjimit zogist: Revolucioni i Qershorit 1924, Kryengritja e Fierit në 1935 dhe Kryengritja e Delvinës më 1937.

Revolucioni i vitit 1924 kryhet në fillimet, kur Zogu sapo shfaqej si një dorë e fortë, ndërsa Kryengritja e 35-sës dhe e 37-ës shpërthyen kur regjimi zogist ishte ezauruar, por që ishte ende i fuqishëm për të mundur kundërshtarët e tij. Dy kryengritjet e viteve '30, me përmbajtje dhe ecuri pothuaj të ngjashme, ndonse ndryshojnë nga Revolucioni i Qershorit 1924, që ishte më i thellë e më i gjerë i këtij lloji në historinë e shoqërisë shqiptare gjer në Luftën e Dytë Botërore, kanë të përbashkët të njëjtin kundërshtar dhe të njëjtin synim:

vendosjen e një sistemi demokratik në Shqipëri.

Pasojat e Revolucionit të Qershorit do të ndjeheshin shumë gjatë dhe do të kishin rrjedhoja të dëmshme për proceset e zhvillimit demokratik të shoqërisë shqiptare. Shoqëria shqiptare për herë të parë përjetoi pluralizmin politik në vitet 1921-24, ku spikati opozita parlamentare e vitit 1924, e para opozitë demokratike moderne e mbrujtur nga figura të shquara dhe e udhëhequr nga Fan S. Noli. Ishte koha kur para shtetit shqiptar ngrihej e mprehtë çështja e karakterit të tij. Çështja asokohe shtrohej: ose Shqipëria të qeverisej nga koalicioni i çifligarëve ish-burokratë otomanë dhe nga bajraktarët, të kryesuar nga Vërlaci dhe Zogu, ose pushteti politik të kalonte në duart e liberalëve me formim perëndimor, si Noli dhe Luigj Gurakuqi.

Liberalët thoshnin se Shqipëria nuk mund të behët një shtet modern sa kohë që nuk do të kryheshin reforma radikale ekonomike dhe sociale. Kurse konservatorët thoshnin se këto reforma duhet të bëheshin më gradualisht dhe se para së gjithash duhej vendosur rendi në të gjitha krahinat e vendit. Nga humbja ose fitorja e njerës palë varej se në ç'vazhdë do të hynte dhe cila do të ishte rruga që do të ndiqte shoqëria shqiptare.

Forcat liberale në këtë duel historik dolën të humbura. Dhe kjo jo vetëm për kushtet e jashtme të pafavorshme, por edhe për bazën sociale ende të dobët brenda vendit. Por kjo do të ishte katastrofa, sepse u ndërpre në proceset demokratike të shoqërisë shqiptare, iu hap rruga idolatrisë dhe sundimit personal. Shteti shqiptar, me një shpejtësi të etshme do të kalonte nga rendi republikan në monarki. Dhe ky kalim i servirej kombit shqiptar si një domosdoshmëri, si rruga e vetme

e shpëtimit dhe si garancia e së ardhmes. Përballë i vihej gogoli i Revolucionit të Qershorit si gjoja akt i çmendurisë, anarkisë, vëllavrasjes.

Duhet pohuar se kjo nuk qe rastësi, por tregues i prapambetjes së shoqërisë shqiptare, i shkallës së saj të ulët politike. Baza shoqërore, psikologjike e historike e idolatrisë në Shqipëri kishte rrënjë të vjetra. Një popull afro nëntëdhjetë përqind analfabet, që kishte pasur mbi krye për 500 vjet "baba sulltanin", ku jetonin të gjalla kanunet mesjetare, në Veri me bajraqe e bajraktarë, në Shqipërinë e Mesme me bejlerë tiranikë anadollakë, në Jug me idhullin e kryekapedanëve, krijonte kushte për të krijuar idolatrinë. Këtë bazë shoqërore e këtë psikologji do të shfrytëzonte Zogu për t'u kthyer në monark. Tipike është mbledhja e parisë së maleve në Tiranë, më 31 Janar 1925, ku Zogu merr "besën".

Dihet se në shtetet totalitare, ku asfiksohet liria e mendimit dhe e veprimit, ku çdo reagim kundër idhullit quhet tradhëti e lartë kombëtare, është tepër e vështirë të veprojë forca demokratike, pasi censurohet gjithçka me rreptësinë më të madhe.

Kështu ndodhi dhe me dy kryengritjet kryesore kundër monarkisë më 1935 dhe 1937, që do të mbaronin me disfatë, duke mos gjetur dot hapësirën e nevojshme, duke mos mundur të ngriheshin në shkallën e duhur të organizimit dhe duke mos pasur mbështetjen e gjerë sociale. Ata që i organizuan këto kryengritje qenë të ndërgegjegjshëm për raportin e pafavorshëm të forcave, por të gatshëm të sakrifikoheshin, të shtyrë nga një idealizëm i zjarrtë atdhetar. Kjo është edhe kuitensenca që i bën Ismet Totua Kryengritjes së Delvinës kur i përgjigjet kryetarit të trupit gjykues:

“Por kur s’keshët shpresë për të fituar, pse e bëtë këtë sakrificë? Sigurisht këtë pyetje, zoti Kryetar, e bëjnë shumica e shqiptarëve dhe pak janë ata që e gjejnë përgjigjen. Përgjigjia ime është kjo: ...Kur është çështja t’i futesh një pune, kur nëntëdhjetë përqind përfundimi është vdekje, aherë aty duhet një pasion i fortë, një shtytje idealistike e pazaptueshme. Duhet, me fjalë të tjera, të kesh arritur një të tillë gjendje shpirtërore sa nuk durohet më dhe nuk mund të bësh më ndryshe, veçse t’i futesh rrezikut me gjoks të hapur dhe të sakrifikohesh i gjithë. Ata që kanë tru të mendojnë, ata që kanë zemër të ndjejnë, shpesh herë vijnë në të tilla gjendje shpirtërore dhe, kur vijnë gjer aty, do ta bëjnë një send, do ta gjejnë një udhë për të përfunduar. Im vëlla kish arritur në këtë gjendje. Ai besonte se punët e këtij vendi venë mos më keq, për shkak se janë organizuar në mes tyre nja 40-50 veta dhe me intriga e shpifje kanë mundur të shtien në dorë një pjesë të madhe të fuqisë shtetërore dhe bëjnë ato që kanë bërë, dhe bëjnë ato që dihen nga të gjithë. Ai besonte se kjo klikë e organizuar u themelua definitivisht dhe shqiptarët arritën një të tillë shkallë demoralizimi sa askush s’guxon të bëjë zë dhe kështu gënjeshtria e korrupsioni filluan të shtien rrënjë të thella dhe të rrezikshme. Nga këto e shumë shkaqe të tjera, që s’është nevoja t’i radhis këtu, ay besonte se dikush duhet të bënte një sakrificë që kish kuptimin e një proteste morale, që të provonte se ata që e duan këtë Atdhe me gjithë shpirt, kur u mbushet mendja se Atdheu ka nevojë për sakrificë, e bëjnë. Dhe im vëlla, siç dihet, ish nga ata që s’kish kursyer kokën e tij dhe në raste të tjera kur ish në shërbime me rëndësi të Mbretit e Shtetit. Ashtu dhe këtë radhë iu fut rrezikut dhe u sakrifikua në një mënyrë aq të thjeshtë e aq të pastër, sa që çuditi shumicën e shqiptarëve që rrojnë për të ngrënë e për të rritur fëmijë.”

5. Si dhe pse e shtrëmbëruan karakterin e Kryengritjes së Delvinës.

Në trajtimin që i është bërë Kryengritjes së Delvinës nga monarkia zogiste dhe më pas nga diktatura komuniste, ajo është vendosur në të dyja skajet: e para e shpalli *bolshevike*, kurse tjetra *fashiste*. Tërheq vemendien fakti se i janë vënë dy etiketime që, për secilën periudhë, të paktën zyrtarisht, kanë qenë më të përbuzurat. A mundet vëllezërit Toto, që qenë organizatorët dhe udhëheqësit e kryengritjes, të ishin në të njëjtën kohë *edhe bolshevikë edhe fashistë*?

Edhe në "Historia e popullit shqiptar" të sapo botuar, teksti për kryengritjen e Delvinës lë mjaft për të dëshiruar si nga mënyra si është hartuar, ashtu dhe nga cektësia e vështrimit. Kryengritjes së Delvinës i është lënë një kënd i vogël leximi dhe është trajtuar me një gjuhë të ndrojtur, jo pa ekuivoke si dhe me pasaktësira që nuk janë serioze për një tekst historie.

Në monarkinë zogiste dhe në diktaturën komuniste 50 vjeçare, historianët, ndonse në shkallë të ndryshme, qenë të detyruar të hynin në lojë vetëm duke iu përmbajtur recetës së ustait. Receta e parë për Kryengritjen e Delvinës u dha nga Pallati Mbretëror, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme me dy telegrame, njëri drejtuar Prokurorit të Gjykatës së Posaçme për faje politike dhe tjetri Prefektit të Gjirokastrës, ku thuhet: "*Këta kriminelë në veprimet e tyre kanë ngjashmëri me bolshevikët në Rusi dhe me luftën që bëhet në Spanjë... Përgjigjet që prokurori do t'u japi të pandehurve në gjyq, vjen vevetiu se do të jenë me tezën më të bukur që e mendon ai vetë, për me iu hedhë poshtë pretendimet e tyre, por përveç kësaj, prokurori*

duhet të porositet që ndër këto përgjigje mos harrojnë me shtie edhe poza për me dhanë kuptim që lëvizja ka qenë me tendenca komuniste”¹⁵.

Kjo prapaskenë u var në gozhdë të turpit në fjalën e mbrojtjes të Ismet Totos kur akuzoi: *“Kjo çështja e komunizmës është edhe modë edhe nevojë. Nacionalistët e mëdhenj, siç i quan zoti prokuror, që punojnë nëpër zyra e kolltuqe nga drejtohen e organizohen punët e prokurorisë të gjyqit për faje politike dhe shërbimet e ndryshme analloge, nuk janë aq budallenj sa të thonë të vërtetën, siç u provua sheshit në këtë gjykatë se lëvizja e Delvinës është një lëvizje kontra tyre. Ata dinë ç’bëjnë. I japin lëvizjes një ngjyrë komuniste dhe kështu dalin vetë nga mesi dhe justifikojnë ata dhe masat që dëshirojnë të marrin.”*

Dhe menjëherë filloi loja me të pandehurit. Siç ndodh zakonisht në këto raste, thyhen të parët ata që çmojnë mbi gjithçka lëkurën e tyre. Dhe hetuesia përgatiti për gjykatën dy të tillë: Ali Nivicën dhe Shefqet Gjolekën. Kjo përzgjedhje plotësonte edhe kushtet për një farë besueshmërie. Ali Nivica dhe Shefqet Gjoleka bënë pjesë në shtabin e kryengritjes. Nga regjimet diktatoriale ngulitet çmendurisht ideja e përjetësisë së pushtetit të tyre. Mendohet se dosjet e dënimeve me burgim të përjetshëm të mbyllura në kasaforta s’do të kenë mundësi t’i hapë dorë tjetër dhe kjo vetsiguri bën të mbeten të dokuentuara saktësisht biografite e tyre.

Në deponimet e para, Ali Nivica e shpall kryengritjen “kryengritje fashiste”. Sipas tij, *“Toger Tajar Goxho i ka thënë se Et’hem i ka përkrahjen e Musolinit, se konti Ciano nuk asht nda mirë dhe nuk ka mbet dakort me qeverinë e Tiranës.*

¹⁵⁾ AQSH, Fondi “Kryengritja e Delvinës”, Dosja nr. 35/2a, faqe 1348

Togeri më tha se gjashtë kasa me municion kanë ardhë prej Italie dhe na i ka dorzue Agjenti konsullor Italian i Sarandës”.

Ky deponim është i process-verbalit mbajtur në hetuesi më 26 Maj 1937. Mirëpo, kur hetuesisë iu desh diçka tjetër, sipas urdhërit të marrë nga lart, po ky Ali Nivicë, më datë 11 Qershor 1937 deponon: *“Për herë të dytë që takova Et’hemin në Delvinë m’u dftue tepër i pakënaqur nga situata politike e Shqipërisë dhe nga Regjimi. Më tha “kam tre vjet që po studjoj dhe elaboroj një plan për rrëzimin e rregjimit dhe vendosjen e Bolshevizmit.” Sa herë që jam takue më shfaqte se kishte ide të nalta dhe këto idena frymëzoheshin nga parime komuniste anarshiste”*

Në hyrje të këtij proces-verbali, Ali Nivica, për të justifikuar faktin që deponimet janë kaq të skajshme, deklaroi: *“... dzyzetetë orë etje... dhe mbas dorëzimit që bëra dje... nuk kam qenë në gjendje llogjike normale dhe nga kjo do rrjedhë ndryshimi ndërmjet deponimeve të para dhe këtyre që po bëj tash të cilat janë plotësisht të drejta”.*

Mirëpo, po ta studjosh me kujdes ligjëratën e tij, në deponimet e datës 26 maj, Ali Nivica nuk duket aspak anormal. Por le ta marrim për momentin në konsideratë si të vërtetë thënien e Ali Nivicës se Et’hem Toto ka marrë gjashtë arka me municion nga një shtet fashist, çka përbën një provë materiale. Po ç’na thonë faktet? Nga Delvina u nisën jo më shumë se 70-80 kryengritës. Një pjesë e mirë e tyre, siç del edhe nga deponimet në hetuesi, arrijnë gjer në Gjirokastrë të paarmatosur, megjithëse marrin krejt armatimin e depove të Delvinës, të postave të Muzinës, të Sofratikës dhe sidomos të postës së xhandarërisë dhe të Rojes Kufitare në Jorgucat. Nevojën për armatim kryengritësit e ndjejnë edhe gjatë marshimit për në Vlorë, edhe pse shtinë në dorë edhe armatimin e

prefekturës së Gjirokastrës dhe nënprefekturës së Tepelenës.

Gjithashtu, po sipas dëshmisë së Ali Nivicës, gjatë përpjekjes në Qafën e Plloçës, në makinën ku udhëtonte ai, nga të pesë xhandarët, dy prej tyre ishin pa armë. Ç'u bënë pra gjashtë kasat me municion që kryengritësit "kishin marrë nga agjenti i konsullit Italian në Sarandë"?

I pandehuri tjetër, ku u mbështet gjykata për ta quajtur kryengritjen bolshevike, është Shefqet Gjoleka, i cili, sipas Ismetit, s' ishte ngritur kurrë më lartë se "në rolin e një rojëtsi, të një polici e të një informatori". Ai deponon se Et'hemi i paska thënë: "*Sa të zejmë Vlorën do të përqëndrojmë fuqitë në Mifol dhe, si të zëmë arkat e shtetit dhe ato të doganave dhe të marrim prej pasanikëve çka t'u gjendet dhe t'ju shpërnda jme në popull dhe kështu, me një fuqi të mjaftueshme do të vemi në Tiranë dhe atje do të shpallim komunizmin*". Deponuesi vahdon: "*... tue udhëtue më pat thënë Et'hemi se, kur të shkojmë në Vlorë do të na vijmë dy vapura me dymijë armë nga Jugosllavia e tjetri nga Greqia*". Me një fjalë, po të merren të vërteta deponimet e "dëshmitarit" Shefqet Gjoleka del se monarkitë e Ballkanit, Jugosllavia dhe Greqia, do të ndihmonin bolshevikun Et'hem Toto të vendoste regjimin komunist në Shqipëri! Sipas kësaj dëshmie, "bolsheviku" Et'hem Toto s'qenkish lidhur vetëm me Italinë, por edhe me Jugosllavinë e Greqinë. "*Këto janë gënjeshtër që i kupton edhe një foshnjë*", - ishin fjalët e Ismetit në gjyq për këto akuza.

Të bën përshtypje se të pandehurit Ali Nivica dhe Shefqet Gjoleka përdorin fjalët e të dytëve, të atyre që nuk janë gjallë (të Tajar Goxhos dhe Et'hem Totos) dhe është interesante sesi ata nuk kanë zhvilluar qoftë edhe një bisedë me një nga udhëheqësit dhe ideatorët e

kryengritjes që janë gjallë, p.sh. Ismet Toton, i cili, sipas tyre, paska qenë ndërlidhësi me Italinë, apo me Ismail e Xhelal Shtëpanin. Kuptohet që këtë manovër hetuesia e ka përdorur për të mos dalë bllof, se Ismeti, ndryshe nga dy të parët (Et'hem dhe Tajari), nuk e ka gojën të mbyllur. Ismeti në mënyrë të prerë në deponimet dhe në fjalën e mbrojtjes, madje dhe në një bisedë private me prefektin e Gjirokastrës, përsërit po të njëjtin pohim: *"Asnjë marrëveshje, as me jashtë as me të brendshëm nuk kemi pas, as dhe me një shtet të huaj"*¹⁶.

Në fakt, gazetatat italiane dhe radiostacioni i Barit e quanin kryengritjen e Delvinës "rebele" e "anarshiste" dhe mbajtën po atë qëndrim armiqësor ndaj saj si edhe fqinjët ballkanikë. Duhet vënë në dukje se marrëdhëniet italo-shqiptare në këtë periudhë ishin në muajin e mjalitit. Mbreti Zog ishte dorëzuar pothuaj krejt para presioneve, kështu që Duçes s'mund t'i interesonte zëvendësimi i mbretit me një person tjetër që mund t'i sillte telashe, aq më tepër me vëllezërit Toto që njiheshin si nacionalistë të sprovuar. Dhe kur ndjehesh të frynin erëra të tilla rretherrotull, Ismeti do të shkruante: *"Ka disa shqiptarë gjysëm të vdekur që do të buzëqeshin ironikisht kur dikush flet për forcat e popullit shqiptar duke përfytyruar se "...ç'mund të bëjnë njëmilionë njerëz?"* Këtyre shqiptarëve dhe të huajve, në qoftë se të tillë ka, u përgjigjemi se ne jemi një popull që kemi fituar me gjak dhe me zotësi lirinë tonë. Ne jemi të kënaqur që të na lenë të lirë që kështu të punojmë dhe të qytetërohemi, të zhvillohemi e të shijojmë edhe ne të mirat e qytetërimit. Por, në qoftë se na preket sedra jonë, qytetërimi ynë, ekzistenca jonë shtetërore në cilëndo mënyrë qoftë, duhet të dihet prej gjithkujt se ajo që ka dijtur të bëjë

¹⁶ Marrë nga Proces-verbali idatës 28.51937

populli shqiptar në këto raste ka qenë dhe do të jetë: me vdekë... I nderojmë miqtë, por nuk i jemi mirënjohës kurrkujt për lirinë tonë. Liria jonë garantohet vetëm me vendimin t'one për të vdekur kur është rasti. Këtë e din dhe e ndien i tërë populli shqiptar"¹⁷.

Vetë Et'hem Toto, udhëheqësi i kryengritjes, para se t'i jepte fund jetës në malet e Kurveleshit, la të shkruar e të nënshkruar me dorën e tij testamentin e fundit të kryengritjes, ndoshta me të vetmin qëllim që të mos keqinterpretohet ajo: "Tash në minutën e vdekjes thërras: Poshtë tirania! Rroftë Nacionalizma. Unë jam vetëm krijues i këtij revolucioni, as kërkënd tjetër dhe as gjisht i huaj. Mali i Golemit 25 Maj 1937. E. Toto"¹⁸.

Dhe praktika tregoi se Et'hemi e ka pas njohur mirë intrigën e Zogut dhe të klikës së tij, ndaj edhe e la atë testament në minutat e fundit të jetës së tij, pasi autoritetet qeveritare, jo vetëm që nuk i lejuan hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit të mos e nxirrnin në gjyq këtë dokument autentik, po u përpoqën edhe ta zhduknin atë. E megjithatë, ai dokument nuk i pengoi as autoritetet zogiste dhe më pas, sikundër do ta shohim, as ato komuniste për ta deformuar qëllimin dhe inspirimin e vërtetë të asaj kryengritjeje.

Historiografia komuniste të njëjtën *xhaketë* interpretuese zogiste për atë kryengritjeje e kthen në anën tjetër: akuzën e politikës zogiste për karakterin *bolshevik* të kryengritjes e quan lojë dhe nxjerr në skenë kartën tjetër, duke e cilësuar atë si kryengritje *fashiste* e nxitur nga fashistët italianë.

¹⁷⁾ Që ta fillojmë, "Arbëria", 11.02.1936

¹⁸⁾ Dosja nr. 56, faqe 1

Që ajo kryengritje nuk ishte as fashite në përmbajtje dhe as e nxitur nga Italia, (pasi nuk mund të ndodhte një gjë e tillë sepse edhe vetë Zogu ishte në muaj mjalti me Italinë), na e shpjegon edhe historiani amerikan Bernd J. Fisher, kur analizon qeverinë e kryesuar nga Mehdi bej Frashëri, në të cilën bënte pjesë Et'hem Toto, e cila ishte zevendësuar nga një qeveri filoitaliane, i cili shkruan: *“Sidoqoftë, lëshimi më i madh i Mbretit ishte formimi i një qeverie të re, në mes të Tetorit 1935, relativisht liberale, nën drejtimin e Mehdi bej Frashërit. Emërimi i Mehdi beut si Kryeministër përbënte një shkëputje kuptimplotë prej të kaluarës politike të Shqipërisë... Ministri i ri i Punëve të Brendëshme, Et'hem Toto, ishte njeri i ndershëm e i varfër, ndërsa ministri i Jashtëm, Fuad Asllani, përshkruhej si njeri i aftë dhe inteligjent. Qeveria e re u përshëndet prej këtij vendi me një ndjenjë lehtësimi dhe me një simpati të madhe popullore... Mehdi beu u rrëzua në nëntor 1936, kur ai dhe qeveria e tij dhanë dorëheqjen pas një vote mosbesimi nga ana e Parlamentit. Përmasat e kësaj vote tregonin qartë se prapa saj fshihej Mbreti... Natyrisht në analizë të fundit Mehdi beu ra se Mbreti dëshironte që ai të binte. Mbreti e quajti më të udhës që ta zevendësonte Frashërin dhe kolegët e tij anglofilë me njerëz që shiheshin disi më me simpati prej Romës. Koço Kota, dora e vjetër që mori në dorë qeverinë e re, ishte jo vetëm skrupuloz në besnikërinë e tij ndaj Zogut, por gjithashtu edhe mik i vjetër i italianëve, dhe për këto cilësi i përshtatej mirë këtij kallëpi”¹⁹.*

Edhe në “Historinë e Shqipërisë” e vitit 1965 pohohen përfundimet e nxjerra nga Bernard Fisher, dhe po citojmë: *“Më 27 prill 1936 legjislatura e dytë e parlamentit, ku*

¹⁹ Bernard J. Fischer “Mbreti Zog dhe përpjekia për stabilitet në Shqipëri”. Tiranë. Çabej, 2000. f.258 dhe 260.

mbizotëronin "të vjetrit", mori fund. Qeveria e Mehdi Frashërit u përpoq ta shfrytëzonte këtë rast për të eliminuar nga parlamenti me anë të zgjedhjeve të reja kundërshtarët e saj.... Fushta e zgjedhjeve për parlamentin e ri i dha luftës politike një karakter shumë të ashpër. Mjeti më i fuqishëm propagandistik i "të vjetërve" ishte akuza që i bënin qeverisë së M. Frashërit si nxitës të lëvizjes revolucionare dhe të "anarkisë" në Shqipëri. Me "të vjetrit" kundër qeverisë u reshtua tani edhe vetë mbreti... Qëndrimi i mëtejshëm në fuqi i qeverisë së M. Frashërit nuk i premtonte asgjë të mirë klikës zogiste. A. Zogu dhe "të vjetrit" kishin nevojë për një dorë më të fortë që t'i shtypte "masat e rebeluara" kundër regjimit. Këtë e dëshironin edhe padronët e A. Zogut, fashistët italianë... Meqenëse votbesimi nuk iu dha, qeveria e M. Frashërit më 7 nëntor 1936 dha dorëheqjen. Pas dy ditësh u shpall formimi i qeverisë së re nën kryesinë e Koço Kotës, e përbërë nga elementët më reaksionarë, me ministër të brendshëm famëkeqin Musa Juka".²⁰⁾

Historiografia komuniste spekulon me idenë e Ismetit, i cili theksonte se Diktatura e Ndritur Nacionaliste ishte më efektivia për ta çuar kombin përpara, duke i kombinuar këto me një pjesë të deponimeve të Ali Nivicës dhe Shefqet Gjolekës dhe me ndonjë thënie të shkëputur nga konteksti i ndonjë dëshmitari tjetër. Dhe atë spekulim e shohim edhe në ribotimin e "Historisë së Shqipërisë" të vitit 1984, e cila, njësoj si botimi i "Historisë së Shqipërisë" e vitit 1965e cilëson këtë kryengritje "puç atizogist", por duke bërë edhe këtë shtesë: "Në të vërtetë puçi u shkaktua nga pakënaqësitë dhe synimet ambicioze të ish-ministrit të Brendshëm dhe nën nxitjen e vëllait të tij Ismet Totos, pjesmarrës kryesor në lëvizje i cili

²⁰⁾ "Historia e Shqipërisë", Vëll.2, 1965, botim i Institutit të Historisë, f.645-646

deshi të zbatonte idetë e tij me ngjyrë fashiste të "diktaturës së ndritur", synime këto që miratoheshin edhe prej Romës. Në lëvizje morën pjesë edhe elementë patriotë që nuk i njihnin qëllimet e vërteta e prapaskenën e saj dhe donin të përmbysnin regjimin zogist"²¹⁾.

Mirëpo, sikundër shihet nga citimi i mësipërm, historianët e regjimit komunist duket që janë të urdhëruar ta trajtojnë Kryengritjen e Delvinës si "*puç antizogist*" dhe me "*ngjyrë fashiste*", pasi, menjëherë pas etiketimit "*puç antizogist*" e quajnë me përsëritje "*lëvizje për përmbysjen e regjimit zogist*". Këtu kemi një kontraditë të vetë historianëve komunistë, në cilësimin e saj: edhe "*puç antizogist*" edhe "*lëvizje për përmbysjen e regjimit zogist*"! O njera, o tjetra, pasi lëvizjet as që mund të ngjasojnë e jo më të krahasohen kurrë me një *puç* e aq më shumë me "*një provokim të vogël fashist*", sikundër shprehet Enver Hoxha. Gjë që nuk është thjesht një lapsus i atyre historianëve, por bindje e tyre që kemi të bëjmë me një lëvizje të mirëfilltë idealiste, por që nuk guxonin ta shprehnin hapur, se Kryengritja e Delvinës ishte thjesht një kryengritje e vërtetë me tendenca thjesht nacionaliste, e aspak një kryengritje me tendenca *bolshevike* apo *fashiste*.

Një çerpi (sebe) tjetër i historianëve komunistë për t'i dhënë asaj kryengritjeje ngjyra fashiste e të nxitur nga Roma, shfrytëzojnë faktin ngaqë Et'hem, sipas deponimeve të disa të akuzuarve në gjyq, ka pohuar disa herë gjatë marshimit kryengritës se, arritja në Vlorë ishte çelësi i suksesit. Dhe mbi këtë shprehje është interpretuar se gjoja në Vlorë do të zbarkonin forca fashiste, në bazë të një marrëveshje të

²¹⁾ "Historia e Shqipërisë", vëll. 3, Tiranë, 1984, f. 412. Botim i Akademisë së Shkencave dhe e Institutit të Historisë

fshehtë, por duke mos na sjellë asnjë fakt në mbështetje të atij "përfundimi". Por edhe ky interpretim i historianëve komunistë rëzohet nga trajtimi i mëposhtëm, që vetë ata kanë shkruar në Historinë e Shqipërisë në viet '60, ku theksohet se marrëdhëniet e A. Zogut me Italinë fashiste po shkonin drejt një aleance shumë herë më të fuqishme se deri atëherë, të cilën po e citojmë:

"Klika e A. Zogut, e cila e kishte futur krejtësisht Shqipërinë në orbitën e fashizmit Italian, e kuptonte fare mirë se ajo mund të qëndronte në fuqi për aq kohë sa do ta kërkonin intereset e Romës. Në pamundësi të bënte një politikë të jashtme të pavarur, ajo i ndiqte me shqetësim marrëdhëniet e Italisë me Jugosllavinë dhe Greqinë, duke pasur gjithnjë frikë nga një afrim i tyre që mund të shpinte në likuidimin e regjimit zogist në Shqipëri. Për këtë arsye marrëveshja anglo-italiane e 2 Janarit 1937, sipas së cilës të dy palët siguronin status-kuonë politike dhe tokësore në të gjithë sektorët e Mesdheut, e gëzoi Zogun...Në prill 1937 erdhi vetë në Tiranë si "mysafir" i A. Zogut ministri i jashtëm Italian G. Çiano. Po atë muaj erdhi në Tiranë edhe organizatori i agjunkturës fashiste në Shqipëri Xhovan Xhiro"²²⁾

Po si është e vërteta?

Nuk është e vërtetë se në Vlorë pritej ndihma e një force të jashtme. Kryengritësit shpresonin që, pasi të kishin zotëruar dy qarqe, atë të Vlorës dhe të Gjirokastrës, do të ishin në gjendje t'u bënin ballë forcave të mbretërisë. Shpresa e fitores ishte të forcat e brendëshme të

²²⁾ "Historia e Shqipërisë", vëll. 2, Tiranë, 1965, f. 648-469, Botim i Institutit të Historisë

pakënaqura nga regjimi zogist, jo vetëm në shtresat e gjera të popullit, po dhe në rrethet e larta ushtarake dhe civile. Po qe se do të mungonte kjo përkrahje, kryengritja do të dështonte. Et' hemi, për t'u dhënë kurajo bashkëpunorëve të tij, qëllimisht paraqitet sikur ka lidhje të shumta, madje, siç e kemi parë, përmend edhe emrat e personaliteteve të ndryshëm. Ndoshta ka përmendur edhe Italinë. Por për Italinë në atë kohë çdo pikë e Shqipërisë nuk ishte më e largët se Vlora.

Përgjithësisht gjat diktaturës komuniste ndaj Kryengritjes së Delvinës u mbajt një qëndrim shpërfillës. I vetmi studim më i plotë gjat asaj kohe iu besua një kursanti të Shkollës së Partisë, E. Kaba, pa kurfarë emri si studjues, dhe që i vuri studimit të tij titullin përçmues "Kryengritja puçiste e Delvinës". Kursanti i zellshëm i asaj shkolle, sikundër vihet re, citon fraza të shkëputura të të pandehurve jashtë kontekstit, me qëllimin si e si për të shtrembëruar të vërtetën e asaj kryengritjeje, duke iu shmangur çdo lloj ballafaqimi të dokumentuar. Hamendiet, dyshimet, dëshirat ai i merr si fakte për të arritur në përfundime të paracaktuara. E vetmia e re që sjell E. Kaba, janë deklaratat e ish të pandehurit të atij gjyqi të vitit 1937, Idajet Shehu. Por tashmë, pas 40 vjetësh, Idajet Shehu nuk depononte nga qelitë e ftohta të kalasë së Gjirokastrës, por nga një divan komod, duke pirë kafe me "historianin" e Shkollës së Partisë. Idajet Shehu, kur po i flet kursantit të Shkollës së Partisë "V.I. Lenin", kish harruar që në ato ditë qelie të vitit 1937 ai e kishte dhënë "prova" se e çmonte shumë lëkurën e vet. Dhe kjo vërtetohet nga dosja hetimore e atij gjyqi të para 40 viteve, ku mësohet se në çastet e fundit, kur Ismet Toto do të delte nga qelia dhe do të ekzekutohej me varrje në litar,

në Kalanë e Gjirokastrës, i besoi Idajet Shehut, si bashkëfshatarë që ishin, testamentin e tij të fundit, "De profundus", të shkruar me dorën e vet. Atë e mori përsipër ta kopjonte edhe Teki Koloneci që ishte edhe ai në të njëjtën qeli në burgun e Gjirokastrës, i cili e ruajti atë kopje, e që ka arritur gjer më sot; ndërsa Idajet Shehu tekstin origjinal e grisi²³⁾. Idajet Shehu, një prej dëshmitarëve të gjallë të asaj kryengritjeje, na deponon përsëri për Kryengritjen e Delvinës, pas 40 vjetësh, më 1977, na thotë se: *"Et'hemi më thirri në shtëpinë e tij dhe më tha se kemi vendosur të bëjmë kryengritje kundër Zogut, a pranon të marrësh pjesë? Unë i thashë se për të luftuar kundër rregjimit të Zogut jam gati që tani, por mua nuk më besohet që me forca të pakta të nisemi nga Delvina dhe të arrijmë në Tiranë për të rrëzuar Mbretin, dhe thashë vargje të një kënge popullore... me të cilat doja t'i thoshja se nuk mund ta marrim përsipër një barrë aq të rëndë, të hedhim pesë pushkë për të bërë zhurmë dhe të vemë atdheun në rreik me ndërhyrjen italiane; të nxijmë kështu veten tonë dhe të ardhmen e fëmijëve tanë. Si përgjigje Et'hemi më tha: Mos ki merak për rrezikun e Italisë. Ne kemi biseduar me Konsullin italian të Sarandës për kryengritjen që mendojmë të bëjmë dhe kemi marrë sigurinë se italianët nuk janë kundër kësaj lëvizjeje. Gjithashtu shpresat tona, vuri në dukje Et'hemi, i kemi mbështetur tek traktati italo-shqiptar, të cilit Zogu i trëmbet sepse Italia mund të ndërhyjë në Shqipëri dhe Zogu do detyrohet të bjerë në marrëveshje me ne"*²⁴⁾.

Vini re se sa bukur e paska bërë zoti Idajet analizën e situatës konkrete në Shqipërinë e atij viti! Së pari, nga ato që deklaroi pas 40 vjetësh, ai del si një patriot

²³⁾ Burgu i Gjirokastrës, *Proces-verbal i datës 19.XI. 1937*

²⁴⁾ Lëvizja puçiste e Delvinës, *Studime historike*, nr.4, 1977, f.139

tejpamës për rrezikun Italian dhe si një antifashist i vendosur. A nuk mbetesh i çuditur se si një "analist" kaq i hollë të merrte pjesë në një kryengritje fashiste, në kundërshtim me bindjet që ai kish, madje jo thjesht si një pjesmarrës dosido, por si një drejtues i saj, ndryshe nuk kish pse dënohej me 20 vjet burg? Por, me sa kuptohet, Idajet Shehu, kur ka dhënë këtë deklaratë në vitin 1977, duhet të ketë qenë i bindur se nuk ekzistonte më deklarata e tij dhënë në hetuesi para 40 vjetëve. Prandaj ia vlen të shohim se çfarë ka deponuar Idajet Shehu në hetuesinë e Gjykatës për Faje Politike të Posaçme në Gjirokastrë, në vitin 1937: *"Nuk asht e vërtetë qi unë të kem qënë në shtëpinë e Et'hemit kur kanë vendos shpalljen e kryengritjes dhe kur kanë qit pushkë dhe nuk jam nga ata shokët e Et'hemit që në këtë lëvizje të kem lujt rol. Nuk asht e vërtetë qi unë të kem pas dijeni përpara kryengritjes dhe nuk i kam përgatit ndonjë fuqi Et'hemit për këtë qëllim, unë në Delvinë as pushkë nuk kam marrë, por kur e pashë që u keqësue situata këtu në Gjirokastrë mora një armë që ta kisha për mbrojtjen e vetes t'eme... Atë natë kur sosëm te Qafa e Plloçit, plasi pushka mes fuqisë qeveritare dhe asaj revolucionare. Unë atëherë hika e mora rrugën e arratisë tue u ngjit nëpër male.."*²⁵⁾.

Po këtë Idajet, në ditët e para të pushtimit fashist të 1939-ës e shohim antar dhe madje sekretar të fashios në zonën ku punonte. Komentet do të ishin të tepërta. Gjë që tregon se kemi të bëjmë me një dëshmitar të dyshimtë, i cili fare mirë mund të përpunohej për të përligjur tezën e Enver Hoxhës për Kryengritjen e Delvinës, thënë në Kongresin e parë të PKSH, 1948, sipas së cilës: *"mjaftonte*

²⁵⁾ Dosja nr. 14, f. 140-41

një provokacion i vogël nga ana e fashistëve shqiptarë dhe i kurdisur dhe nga fashistët italianë, për të krijuar rastin e volitshëm. Dhe Italia e tentoi këtë provokacion me "kryengritjen" e Et'hem Totos më 1937"²⁶⁾. Ndërsa në "Historia e Shqipërisë" të historianëve të periudhës komuniste, e vitit 1965, Kryengritja e Delvinës nuk etiketohet më "provokacion i vogël fashist", por etiketohet "puç atizogist", dhe konkretisht: "Më 15 maj 1937, në Delvinë shpërtheu puçi atizogist i organizuar nga Et'hem Totua, ishministër i qeverisë së M. Frashërit. Nën udhëheqien e tij, forcat e xhandarmërisë shtinë menjëherë në dorë qytetin... Qeveria e Koço Kotës e paraqiti kryengritjen si të shtytur prej komunistëve"²⁷⁾.

Natyrshëm po lind vetvetiu pyetja: Diktatura komuniste dhe vetë kreu i saj kanë derdhur një lumë anatemas kundër rregjimit monarkist të Zogut, duke e paraqitur veç me ngjyra të zeza, atëherë pse u desh ta sakrifikonin Kryengritjen e Delvinës, e cila ishte kryengritje antizogiste dhe antimonarkiste?

Përgjigja është e thjeshtë. Dihet se në vitet e para të çlirimit nga nazi-fashistët, propaganda shtetërore, Et'hemin, Ismetin dhe krerët e tjerë të Kryengritjes së Delvinës i quante publikisht dëshmorë të atdheut. Mirëpo, sikundër ndodhi jo rrallë gjatë periudhës komuniste me qëndrimet ndaj ngjarjeve dhe personaliteteve historike, duke bërë vlerësime krejt të kundërta për ngjarje apo personalitete të ndryshëm, kjo ndodhi edhe për Kryengritjen e Delvinës dhe organizatorët e saj, pas dënimit të grupit opozitar të quajtur "Grupi i

²⁶⁾ E. Hoxha, vepra, vëll.5, f. 196

²⁷⁾ "Historia e Shqipërisë", Tiranë, 1965, f.649-650

Deputetëve”²⁸⁾, ku pjesmarrës në atë grup ishte edhe pinjulli i fundit i shquar i familjes Toto, Selaudini, vëllai i Et’hemit, Ismetit dhe i Tasimi, i cili qe arrestuar nga Italianët pas 7 Prillit 1939 dhe internuar në Itali dhe kthehet në Shqipëri kur kaptulloi Italia fashiste dhe angazhohet në LANÇ, pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, dhe në zgjedhjet e para parlamentare zgjidhet deputet i Frontit Demokratik. Selaudini kish kryer studimet universitare në Itali para pushtimit të Shqipërisë prej saj. Mirëpo, duke u pushkatuar bashkë me deputetët e tjerë të “Grupit të Deputetëve”, nuk mund të pranohej nga diktatura si e moralshme që një “tradhëtar” i rangut të lartë si Selaudin Toto të rridhte nga një familje me tradita të shquara patriotike.

Për ata që duan t’ia nënshtrojnë faktet logjikës së shëndoshë, s’mund të mos dalë qartë se po qe se Kryengritjen e Delvinës e kishin kurdisur italianët për një ndërhyrje të mundshme, ata kishin një rrjet të tillë spiunazhi në të gjithë Shqipërinë sa që kishin aq mundësi për të mos i lënë kryengritësit të mbaronin në një befasi aq fatale në Qafë të Pllloçës.

Falsifikatorët e historisë nuk kanë munguar në asnjë kohë, por e vërteta herët ose vonë ka dalë në dritë. Kjo mund të thuhet edhe për Kryengritjen e Delvinës, që zë një vend të merituar në përpjekjet e popullit shqiptar për liri dhe emancipim shoqëror.

²⁸⁾ “Këta deputetë. -thuhet në “Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë”,- filluan të shpreheshin hapur kundër shndërrimeve socialiste dhe përpiqeshin të krijonin gjithfarë pengesash në pranimin dhe zbatimin e ligjeve... “Grupi i deputetëve” dhe armiqtë e tjerë brenda vendit nuk gjetën mbështetje në masat... Tradhëtarët e sabotatorët u nxorën përpara gjykatave popullore, ku dhanë llogari dhe morën ndëshkimin që u takonte”. (Shih “Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë”, botim i dytë, Tiranë, 1981. f.215-216)

6. Deponimi i babait të Et'hem, Ismet dhe Tasim Toto, 72 vjeçarit Riza Toto

“Për kryengritjen e bijve dhe të shokëve të tyre, nuk kam pasur dijeni së në ç’mënyrë është organizuar komploti dhe si është vënë në zbatim. Arsya është se unë banoj në një dhomë të veçantë të shtëpisë, pa ardhur në kontakte të dëndura me bijtë e mi. Edhe për kunatin e Et’hemit, Fehmi Godo, - pohon plaku 72 vjeçar - nuk besoj kurrë që dhe Fehmiu të ketë pasur dijeni për pllanin e Et’hemit... Prej djemve Ismeti ishte më i ftohti dhe shumë krenar”. Plaku ankohet se i biri e dëgjonte pak, “ishte ambicioz, dyshoj se guximi i Et’hemit për të bërë kryengritje ka qenë nga Ismeti.

“Në orën gjashtë, - tregon ai,- ndodhesha në Pazar dhe mbasi kam marrë 100 gram raki, që i kisha taim drekë e darkë, u nisa dhe vajta në shtëpi. Nuk arrita mirë në shtëpi, kur nga dera duallën papritur, i pari Xhevdet Gjoleka, kapiten Gjylbegu, Et’hemi, Ismeti, Idajet Lekdushi dhe trimat që kishin nga pas nga Kuçi si dhe Çerçis Shupo, kapter Avdi Golemi, nëntoger Tajar Goxhua dhe këta, sa dualën jashtë në oborr, zbarzën armët, duke shkaktuar trëmbjen e fëmijëve që ndodheshin jashtë duke luajtur. Gratë në shtëpi qanin dhe ulërinin duke thënë: “Burrat na morën në qafë!”²⁹⁾

²⁹⁾ Marrë prej Dosjes 35/1, fleta 633, Delvinë më 25.5.1937

6/1. Nga pohimet e gruas së Et'hem Totos, Myrvete Toto

"Deri ditën e Shtunë në mëngjes, që në mbrëmje do t'u bënte kryengritja, unë nuk kam pas kuptuar gjë. Vetëm 20 ditë përpara e shifshim tepër të mërzitun, as nuk hante, as nuk pinte, as që këndonte në libra, simbas zakonit që kishte. Para se të mirrnim lajmin, nja dhjetë ditë, atij i kishte filluar mërzitja, para se të vinte lajmi zyrtarisht. Et'hemin e kishte lajmëruar N/Kolonel Shefki Shatku se Militër Atashe i Italisë kishte njoftuar se Et'hemi ishte pranuar në shkollë. Më tha:

- Unë sot do të bëj revolucion.

"Unë ndëgjova fjalën revolucion e u trondita e fillova të bërtas. Ai më tha: "Hesht, mos bërtit, se mua për të më vrarë kanë, por unë nuk jam nga ata burra që vriten në Pazar prej një të ligu. Nuk është hasmëria e Sul Shehut dhe e Abdurraman Dibrës, se prej tyre nuk kam frikë, por është dorë tjetër. Cila dorë ishte, mua nuk ma tha".

Sipas pohimit të saj, kur ra kabineti, domethënë Et'hemi u hoq nga Ministër i P. Mbrendëshme, iu kurdisën dy atentate, prandaj është këshilluar nga shokët dhe miqtë e tij, sidomos nga N/Kolonel Shefkiu, në prezencë të gruas së tij që: "Ti Et'hem duhet të ngrihesh që këtej e të shkosh ja në Leskovik, ja në Delvinë, për derisa të ndërojë situata, se ke qënë ministër dy herë, ke zbulue komplete në rrugën e Durrësit tu shkue në banjo të mbretit, ashtu edhe mbasi ra kabineti në Tiranë në kohën e votimeve".

Lidhur me dy të dyshuarit dibranë që kishin ardhur për të vrarë Et'hemin në Delvinë, e shoqja e Et'hemit deklaroi: "Nga ajo shtëpi shumë kollaj do të kryenin

qëllimin e tyre, jo vetëm që shihnin shtëpinë tonë tue hy e tue dalë, por edhe në gjumë mund të na vrisnin”, dhe vazhdoi: “ 20 ditë para kësaj ngjarjeje që tregova, (domethënë për dibranët), gjindarmëria e kishte zanë një njeri prej Lure ose prej Shkodre dhe e ka kthyer për në Shkodër. Ky ka vajtur dhe është ankue në Ministrinë e Punëve të Mbrendshme. Ministria e ka lejue të vijë si tregëtar”.

7. Jehona e Kryengritjes së Delvinës në shtypin ballkanik, european dhe atë botëror.

“Lajmi i një kryengritjeje në Shqipëri, nuk i habiti aspak ata që e njohin pak a shumë historinë dhe temperamentin e popullit shqiptar... Kjo lëvizje nuk qe e huaj, por nga pakënaqësia e fshehur që është provokuar në atë shtet nga politika e Mbretit Zogu I, kryeatyrë e bindur e Italisë.

Dy janë karakteristika e shqiptarit: dashuria e mëvetshme për liri dhe shpirti i tij hakmarrës, burim grindjesh të brendshme të shpeshta”³⁰⁾.

“Një grup revolucionarësh në Shqipëri mori qytetin e Gjirokastrës. Udhëheqës i kryengritjes është ish Ministri i Policisë, Et’hemToto... një person fort i njohur në Shqipëri. Para tetë muajve në qeverinë e z. Frashëri, ka qenë Ministër i Punëve të Brendshme dhe ka luajtur një rol të madh në jetën politike. Ende nuk dihen shkaqet që e shtynë këtë politikan të zotin të bëjë një revolucion të hapur. Mund të besohet se shkaqet kanë qenë vetiake.

³⁰⁾ Revista franceze “Lausanna”, 19.05.1937

Zoti Et'hem Toto është njeri ambicioz"³¹⁾.

"Kryengritja në Shqipëri nuk është likuiduar. Et'hem Totua është në krye të partizanëve të tij. Nuk është dorzuar, lufton akoma...Malet e Kurveleshit janë mbrojtja e tij. Mali i Kurveleshit sikur të' qe krijuar për atë. Ai në vendin e vet, me gjithë që nuk fitoi në zgjedhjet e fundit, është njeri me influence, kështu atë e fshehin dhe autoriteteve nuk u japin asnjë informacion për të. Numuri i të burgosurve është i madh. Disa thonë mijëra vetë, kurse qeveritarët thonë 200 vetë...

Shkaku që e shtyti Et'hem Toton të bëjë kryengritje, nuk është i njohur dhe ende nuk është ndrituar. Kjo është një gjë shumë e fshehtë. E komentojnë si shkak pakënaqësie që ra nga fuqia. Disa këtu gjejnë shkaqe më përtej këtij mejtimi të dytë, prej të cilit nuk duhet të largohemi. Reformat e fundit (qitja) heqja e ferxhesë dhe ngarkesat e rënda të taksave, mosmbarimi i reformës agrare dhe pakësimi i entuziazmës për rregjimin e sotëm janë disa faktorë që kanë rëndësi të mëdha. Disponimi i popullit ka qenë i tillë që, nuk duhej shumë veç sa të hidhej një shkëndijë e vogël dhe kryengritja të pëlciste"³²⁾.

"Lëvizja është serioze meqenëse nuk udhëhiqet nga kryengritës të egër e të zakonshëm, por nga një ish ministër që ka pasur përgjegjësi politike... Lëvizja mund të rrjedhë pjesërisht nga pakënaqësia e shkaktuar nga konçensionet dhënë italianëve prej qeverisë dhe nga pritjet e pëshpëritjet rreth vizitës së Kontit Çiano"³³⁾.

³¹⁾ Fletoria serbe "Vremie", 17.05.1937

³²⁾ Gazeta Pravda e Beogradit, Serbi, 21.05.1937

³³⁾ Gazeta angleze "Daily Herald", Londër, 17.05.1937.

“Lajmet që vinë nga kufiri shqiptaro-jugosllav, nëpërmjet Belgradit, nuk vërtetojnë deklaratat e Agjensisë Zyrtares të shtypit të Shqypnisë, se kryengritja ka karakter komunist. Kryengritja i atribohet moskënaqësisë së shkaktuar nga politika italofile e qeverisë shqiptare, veçanërisht me dhënien e konçesioneve të vajgurit Italisë në Jug”³⁴⁾.

“Et’hem Toto nuk është një kryengritës egërsirë, por një politikan me përgjegjësi, një nga ministrat më të fuqishëm të kabinetit të Të Rinjve të rrëzuar prej mbretit Zog në vjeshtën e kalueme. Ky e kolegët e tij kjenë zavendësue prej një qeverie në të cilën përmbliidhen disa nga ministrant ma të këqinj të Grupit të të Vjetërve... Moskënaqësia asht shtue edhe prej konçesioneve që qeveria po i jep Italisë gjithnji e ma tepër e që arritën kulmin me pritjen që iu ba Konti Çianos në muajin e kaluem në Tiranë.”³⁵⁾.

“Qeveria Shqiptare po përgatitet me zvogëlue randësinë e Kryengritjes në Shqipërinë e Jugut. Por kryengritja asht një provë e shqetësimit në atë vend. .. Et’hem Toto, i cili asht kryetari kryengritjes nuk asht komunist, as qi ka parime komuniste... Qeveria shqiptare çdo qëndresë që i bahet kundër rregimit të saj fashist, e përshkruan si komuniste. Arsyeja e kryengritjes asht e kjartë. Shqiptarët dashurojnë lirinë e jo fashizmin. Italianizimi i vendit kundërshtohet rreptësisht prej të gjithve. Si njeri i kulturës dhe inteligjencës, këtë gjë e kuptoi.”³⁶⁾.

³⁴⁾ Gazeta “The Times”, Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

³⁵⁾ Gazeta “Daily Harald”, Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

³⁶⁾ Gazeta angleze “Manchester Guardian”, Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

“Në vendet e pastruara prej revolucionarëve janë marrë masa të posaçme nga frika se mos bëhet ndonjë tjetër kryengritje, zyrat qeveritare janë të rrethuara prej rojesh shumë të forta. Frika nuk është e kotë.... Janë burgosur shumë prej parësisë së Delvinës, Gjirokstrës dhe Tepelenës. Kjo gjë shkaktoi pakënaqësi të madhe në popull dhe autoritetet u trembën”³⁷⁾.

“Në Shqipëri për mot del një kryengritje. Tirana është e fuqishme, dërgon ushtri dhe e shtyp. Shqiptarët pse bëjnë kryengritje? Shkaku duhet kërkuar në konstitucionin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë. Shqiptari është shumë i vobeghtë. Katundari ndodhet në një “desastreuch” (mynxyrë) ekonomike. Burimet e fitimit dhe tokat, të cilat janë tepër të ngushta, ndodhen në duart e 3-5 bejlerëve. Mbreti Zog, në raport me mundësitë që ka në dorë, i ka siguruar vehtes së tij një grup të gjerë partizanësh. Këta janë duke u ngopur.”³⁸⁾

“Kryengritje në Shqipëri. Kryengritja po përhapet. Masat e qeverisë nuk mund të ndalojnë partizanët e ish Ministrin Toto të zaptojë vende të reja dhe të forcojë disa vende strategjike”³⁹⁾.

Në artikullin “Shkaqet e kryengritjes” shkruhet: “Në Shqipëri deklarohet se kryengritësit janë tue luftue politikën italofile të Ahmet Zogut. Ata deklarojnë se Ahmet Zogu Shqipërinë e ka bërë provincë italiane”⁴⁰⁾.

³⁷⁾ Fletore “Pravda, 27.05.1937. Nr. 11708, Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

³⁸⁾ Fletoria “Haberi”, Turqi, 18.05.1937, Nr. 1917, Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

³⁹⁾ Fletoria “Timpul”, Rumani, 18.05.1937, Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

⁴⁰⁾ Gazeta “Die Stunde” – Vjenë, 19.05.1937, Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

“Shkaqet e furisë politike janë aq të jashtme aq edhe të brendëshme. Shkaqet e jashtme janë traktatet e Italisë me Shqipërinë, të cilat pohojnë se Shqipëria është robëruar prej fuqisë së madhe”. Përsa u përket ndër shkaqet e brendëshme kjo fletore radhit: “Gjendja ekonomike, mjerimi, uria, sistemi administratës shtetërore, etj...”⁴¹

8. Pak historik rreth familjes së Totajve.

Familja Toto ishte me origjinë të hershme nga fshati shqiptar Rabat, në afërsi të Janinës. Për shkaqe përplasjesh të shpeshta më xhandarmërinë turke, aty rreth viteve 1760 emigruan dhe u vendosën në Progonat të Kurveleshit. Në çdo kryengritje të Jugut kundër Turqisë, burrat e fisit të tyre të aftë për pushkë kanë marrë pjesë rregullisht në to. Bazuar në shënimet e Selaudin Totos, mësojmë se Mustafa Toto, gjyshi i vëllezërve Toto të Kryengritjes së Delvinës, ishte misionar fetar, i cili pat ndërtuar me investimet e veta Teqenë Bektashiane të Baba Abazit, në Delvinë.

Belul Toto, një nga kapëdanët shqiptarë që i shpëtoi masakrës së Manastirit, dimë se helmohet më pas me tradhëti nga turqit; ndërsa e shoqja e tij, Saliheja, jetoi me të kunatin e saj Selman Toto, duke menaxhuar gjithë pronat e fisit. Dhe, kur Selmani vritet prej pushtuesve turq, ajo rrëmben armët dhe lufton në këmbë të tij, por vdes aksidentalisht në vitin 1857, duke u përjetësuar në këngët e popullit:

O moj zonjë e Progonate,
Të bukur mënde që pate,
Kullandrise shtatë irate...

⁴¹ Gazeta “neologo”, Greqi, 20.06.1937. Marrë prej Kutisë 12, Viti 1937, Dosja 78, f. 105-148

Familja Toto u largua nga Progonati në vitin 1914 dhe u vendosën në Delvinë, por gjithmonë me interesimin dhe dashurinë për vendlindjen. Dhe këtë e dëshmon fakti që në vitin 1935 Hetem Toto akordoi 30 napolona flori për ndërtimin e ujësjellësit të fshatit Progonat. Edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Totajt iu bashkangjitën asaj totalisht⁴².

9. Lista e personave të shpërblyer prej Mbretit Zog I, e të vrarëve dhe të dënuarve prej tij, që morën pjesë në Kryengritjen e Delvinës

KOMANDA E QARKUT GJINDARMËRISË

GJINOKASTËR 05/06,1937

Lista e oficerave, nën/oficerave, trupa e civilë që kanë marrë pjesë në shtypjen e rebelëve ndodhur në 16/5/1937 në Prefekturën e Gjirokastrës, (Marrë prej Dosjes 35/2b, 15/06/1937, ora: 10.50)

- | | |
|---|-------------|
| 1. Rreshter Xhemal Koçiu, | nga Golemi |
| 2. Mehmet Hoxha, | nga Kolonja |
| 3. Nano Gjoni, | nga Picari |
| 4. Hajdar Levani, | nga Gusmari |
| 5. Magrib Bana, | nga Gusmari |
| 6. Sulo Beqiri, (<i>Toger rezervë</i>), | nga Golemi |
| 7. Shefqet Aliu, | nga Golemi |
| 8. Riza Runa, | nga Nivica |
| 9. Muharrem Duka, | nga Gusmari |
| 10. Servet Maksuti, | nga Nivica |

⁴²⁾ Marrë me shkurtime prej "Historia e Labërisë", vepër e citura, f. 511-512

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 11. Murat Mevlani (Islami), | nga Golemi |
| 12. Zaho Avrami, | nga Çorraj |
| 13. Hysni Lecka, | nga Kuçi |
| 14. Bilal Nivica | nga Nivica, etj. |

Rebela

Rebela civilë = 77 vetë

Rebela ushtarakë e gjindarmë = 31 vetë

Të vrarë

- | | |
|----------------------------|---|
| 1. Et'hem Riza Toto, | nga Progonati, Major. |
| 2. Tajar Goxho, | " " N/Toger |
| 3. Tasim Riza Toto, | " " |
| 4. Ismet Riza Toto, | " dënuar me vdekje në litar. |
| 5. Rexo Hasani, | nga Golemi |
| 6. Shfqet Gjonleka, | nga Kuçi |
| 7. Bejkush Gjonleka, | nga Kuçi |
| 8. Zeman Xhuvani, | nga Zhulati |
| 9. Abaz Jaho, | nga Kashishti |
| 10. Kutbi Tahiri, | nga Bënça |
| 11. Selman Brahimi, | nga Luma |
| 12. Abdi Hasko Nikolla, | nga Golemi |
| 13. Xhelo Levendi, | nga Golemi |
| 14. Hasan Taka, | nga Golemi |
| 15. Balil Meleq Shosha, | nga Golemi, vdiq nga torturat në burgun e Gjirokastrës. |
| 16. Xhevdet Kadri Gjoleka, | nga Kuçi, vrarë me tradhëti në Kuç ⁴³⁾ |
| 17. Bejkush Gjoleka, | nga Kuçi, " " " |

⁴³⁾ Rami Memushaj "Histori e Kurveleshit", vëll.I, Tiranë, 2004, f. 467

EPILOG

Vaje

NË GJUMË TË RËNDË QYSH RE!

Ç'të gjeti Progonat nuri?
Mes për mes të shkoi lumi,
Që kur vdiq Alem Beluli.
Alem Beluli, more,
Të dhanë helm e s'e pe,
Në gjumë të rëndë qysh re?
Kalëroje mbi rrufe...

REXHO TRIMI, REXHO NURI

Rexho trimi, Rexho nuri,
Krahu yt shtizë e flamurit,
Pse s'zure një rrëzë guri,
Të vrisje sa të çpon plumbi.
Të vranë, o Rexho, të vranë,
Tok me Hetem Progonanë,
Ç'u mori plumbi në ballë,
Me ligje motrat u qajnë.

REXHO TRIMI, REXHO NURI

Rexho trimi, Rexho nuri
Palë e kuqe e flamurit
Pse s'zure një rëzë guri
Të vrisje sa të çpon plumbi.
O Dylbo Bizhga, më thanë
Pse si qan ata luanë
Hetem e Rexho Hasanë
Dhe Avdi Nikoll' e shkretë
Që luftuan me Mbretinë.

SYFAJKUA MES RREBESHIT

Veshur malet me xhandarë, Hetem-o, zëmër-o
Xhahili Mbret dha kumanë, " " "
O të vdekur, o të gjallë, " " "
Të ma biri në Tiranë! " " "
Hetem Toto s'i njeh faljet, " " "
Ishte mal, e mbajnë malet, " " "
Ishte bir i Kurveleshit, " " "
Syfajkua mes rrebeshit. " " "

Këngë

Ç' I GJETI TRIMAT ME FAMË

Ç'i gjeti trimat me famë
Që ligjëronin me pallë
Trihallë, e zeza Trihallë
Nuk ka se kush të të marrë,
Belul Toton e vranë,
Belul Toto Progonanë.
O trim i bukur si ylli
Me ligje të qan bilbili

MALI I GJERË U DRODH SI PENDË

Nata duke gdhirë e Hënë, Det, me det more Ismet
Rënkon dheu nën këmbë, " " "
Mali i Gjerë u drodh si pëndë, " " "
Që nga maja gjer në rrënjë, " " "
Në kalanë hijerëndë, " " "
Katër bijtë e tu, moj nënë ⁴⁴⁾, " " "
Vdekjen e presin me këngë. " " "

⁴⁴⁾ Ata ishin: Ismet Toto, Ismail Gjylbegu, Xhelal Shtëpani dhe Ramadan Muhameti.

SI LISI MES KIAMETI

Hetem Toto duf tërmeti
Ç'ta bëri prima dovleti
Si nga mali dhe nga deti
Në mal të Golëme mbeti
Si lisi mes kiameti.

PERMBAJTJA

PROLOG	5
NË DOSJET ZOGISTE.....	9
Kurthi i dështuar i Ahmet Zogut	11
DY ATENTATE	14
KRYENGRITJA E DELVINËS.....	16
1. Organizimi dhe taktika që u ndoq.	16
2. Pasqyrimi i kryengritjes nga shtypi vendas	26
3. Disa hollësi mbi planin e kryengritjes	27
4. Rrethanat historike, mendimi social-politik i Kryengritjes së Delvinës dhe shkaqet e dështimit të saj.	35
5. Si dhe pse e shtrëmbëruan karakterin e Kryengritjes së Delvinës.	52
6. Deponimi i babait të Et'hem, Ismet dhe Tasim Toto, 72 vjeçarit Riza Toto	67
7. Jehona e Kryengritjes së Delvinës në shtypin ballkanik, europian dhe atë botëror.	69
8. Pak historik rreth familjes së Totajve.	73
9. Lista e personave të shpërblyer prej Mbretit Zog I, e të vrarëve dhe të dënuarve prej tij, që morën pjesë në Kryengritjen e Delvinës	74
EPILOG	76

“Rrëzimi i qeverisë së Mehdi Frashërit pati një rrjedhim tragjik. Një ditë të qershorit 1937 një shpallje zyrtare njoftoi popullin shqiptar se Et'hem Toto, ish-ministër i mbrendëshëm në kabinetin Frashëri, kishte filluar një kryengritje me armë dhe ishte vra në luftë me forcat qeveritare... Misteri i këtij epizodi të përgjakun pret të ndriçohet nga historikuesit e ardhshëm, që do të mund të konsultojnë arkivat e Tiranës, pa mbikëqyrjen e Komisarëve të partisë”.

Tajar Zavalani

“Shkaqet e kryengritjes në Shqipëri, të udhëhequr nga ish ministri Et'hem Toto, deklarohet se kryengritësit janë të luftës politike italofile të Ahmet Zogut. Ata deklarojnë se Ahmet Zogu Shqipërinë e ka bërë provincë italiane”.

Gazeta “Die Stunde”, Vjenë, 19.05.1937

“Qeveria Shqiptare po përgatitet me zvogëlue randësinë e Kryengritjes në Shqipërinë e Jugut. Por kryengritja është një provë e shqetësimit në atë vend... Et'hem Toto, i cili është kryetari i kryengritjes nuk është komunist, as që ka parime komuniste... Qeveria shqiptare çdo qëndrësë që i baret kundër rregjimit të saj fashist, e përshkruan si komuniste. Arsyeja e kryengritjes është e kuartë. Shqiptarët dashurojnë lirinë e jo fashizmin. Italianizimi i vendit kundërshtohet rreptësisht prej të gjithëve. Si njëri i kulturës dhe inteligjencës, këtë gjë e kuptoi”.

Gazeta angleze “Manchester Guardian”, 30.5.1937



Çmimi 400 lekë